



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 06/12/2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT ILIRJAN MANDRO

Nr. 58, datë 06.12.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Edona Dushaj	Kryesuese
Enton Radovani	Relator
Henri Naqellari	Anëtar

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtare e Sekretariatit Teknik, znj. Erlisa Kalaja, në datën 06.12.2024 ora 10:30, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Ilirjan Kadri Mandro, me funksion aktual Drejtor/ Rektor të Akademisë së Sigurisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi relatimin e **relatorit të çështjes z. Enton Radovani**; dëgjoi subjektin e vlerësimit, z. **Iirjan Mandro**, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 06.12.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e Rektorit të Akademisë së Sigurisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi z. Iirjan Mandro është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 04.07.2023 si “Drejtor/Rektor i Akademisë së Sigurisë”.
3. Subjekti i vlerësimit, z. **Iirjan Kadri Mandro**, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr. 54/1 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: z. Enton Radovani, **Relator**, znj. Edona Dushaj, **Kryesues**, dhe znj. Henri Naqellari, **Anëtar**.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr. ***, datë 28.07.2023 vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Iirjan Mandro.
6. Relatori i çështjes, z. Enton Radovani, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar, datë 28.07.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 04.08.2023 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
10. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - ✚ vlerësimin e pasurisë;
 - ✚ kontrollin e figurës;
 - ✚ vlerësimin e aftësive profesionale.

11. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a. Ligji 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
- c. Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”
- d. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”
- e. Ligji nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
- f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”
- g. Rregulloren nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”
- h. duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në Ministrinë e Brendshme që janë:

- ✚ *Deklarata e Pasurisë,*
- ✚ *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
- ✚ *Formulari i Vlerësimit Profesional*
- ✚ *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,*

- i. Raportet përmbledhëse të ILDKPKI-së, Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në AMP, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- j. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
- k. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.

1. ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.
12. Trupa e vlerësimit, me datë 11.11.2024, pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro, me Vendimin nr. ***, datë 11.11.2024, vendosi:
 - a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro,
 - b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - ✚ *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - ✚ *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraparak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
 - c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.
13. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
14. Në datën 20.11.2024, trupa e vlerësimit, njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 21.11.2024, ora 10:30, në ambiente të Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë.

Në fund të seancës dëgjimore të datës 21.11.2024, subjekti i vlerësimit z. Ilirjan Mandro kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Me subjektin e vlerësimit është komunikuar me anë të postës elektronike, duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave. Subjekti i vlerësimit z. Ilirjan Mandro, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në

përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë hetimit.

IV. VLERËSIMI I PASURISË

15. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
16. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit **z. Ilirjan Mandro** ka dorëzuar deklaratën e pasurisë brenda afateve ligjore. Formulari i Pasurisë ka nr. *** index, viti 2023.
17. Procedurat e deklaramit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
18. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
19. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaramet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.
20. **Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**
 - ✚ deklaraten e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
 - ✚ raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
 - ✚ provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
 - ✚ dokumentacionin e paraqitur në deklaramet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike;

21. Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit;

A. DEKLARIMI I PASURIVE

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja;

22. ILDKPKI-ja, në përputhje me Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport¹, të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro, ku është konstatuar se:

- ✓ **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- ✓ **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- ✓ **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- ✓ **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- ✓ **subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

B. PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

23. Bazuar në nenin 34 të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private sipas nenit 34 të ligjit 12/2018; (ç) deklaratimet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik;

¹ Raporti nr. 54/53, datë 04.06.2024, i ILDKPKI-së.

(d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit; (dh) deklaratimet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

24. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, hetim i cili konsistoi në: (I) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, (II) verifikimin e burimeve të krijimit të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllimin evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (III) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (IV) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

DEKLARIMI 1 PASURIVE

Pasuria nr. 1

🚩 Truall 543 m², nga e cila 140.9 m² ndërtesë, me adresë: Rr. “****” Tiranë, në bashkëpronësi me bashkëshorten. Shtuar vlera fillestare prej 4.500.000 lek, me shpenzimet për legalizimin e objektit në vlerën 3.491.400 lek (vlerë e paguar deri në 03.01.2011) duke arritur objekti në vlerën 7.991.400 lek (Rivlerësuar). Data e regjistrimit 20.07.2016.

Burimi i krijimit: Kursime familjare nga të ardhurat e krijuara ndër vite. Zotëron 50%.

Bashkëlidhur deklaratës

- **Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, lëshuar në datën 20.07.2016**, për pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, e llojit truall me sipërfaqe 543 m², nga e cila ndërtesë me sipërfaqe 140.9 m², me adresë: Rruga ***, Tiranë; regjistruar në pronësi të Ilirjan Kadri Mandro.
- **Kartela e pasurisë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk ***, e llojit truall**, me sipërfaqe 543 m², nga e cila ndërtesë me sipërfaqe 140.9 m², me adresë: Rruga ***, Tiranë; regjistruar në pronësi të Ilirjan Kadri Mandro, në datën 21.11.2014, me shënimin “Leje legalizimi nr. ***, datë 18.04.2011 “. Referua përshkrimin të pasurisë, rezultoi: “Në bazë të Lejes së Legalizimit nr. ***, datë 18.04.2011, objekt 3-kat, kati përdhe me sip. 140.9 m², kati i parë me sip. 154.7 m², kati i dytë me sip. 157.7 m². Rivlerësuar në shumën 48.873.347 lek, sipas mandatit datë 22.10.2013.
- **Leje legalizimi nr. ***, datë 18.04.2011**, në emër të Ilirjan Kadri Mandro, për objektin Godinë Banimi 3 kate, me adresë: Njësia Bashkiake nr. ***, Tiranë, me nr. pasurie ***, zk ***, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 543 m², sipërfaqe ndërtimi 140.9 m² dhe

sipërfaqe totale ndërtimi 450.3 m², për banim. Titulli i pronësisë mbi tokën i vërtetuar me: Kontratë kalimi pronësie të parcelës ndërtimore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.01.2011, në bazë të VKM nr. 706 datë 23.06.2009.

25. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **ASHK, Drejtoria e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 21.09.2023**, konfirmon se z. I.M rezulton: vete deklarues për ndërtim pa leje në Njësinë ** Tiranë, sipas shkresës nr. *** prot., datë 2005; vetë deklarues për ndërtim pa leje në Njësinë***, Tiranë, sipas shkresës nr. *** prot., datë 28.08.2006; dhe i pajisur me leje legalizimi, sipas vendimit nr. ***, datë 18.04.2011, për godinë banimi 3-kate.
- **ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2023** konfirmon se në emër të z. I.M rezulton e regjistruar pasuria nr. **, vol. **, faqe **, zk **, përfituar me leje legalizimi nr. *** datë 18.04.2011.
- **Kartela e pasurisë nr. ***, vol. **, faqe **, zk ****, e llojit truall me sipërfaqe 543 m², nga e cila ndërtesë me sipërfaqe 140.9 m², me adresë: Rruga ** Tiranë; regjistruar në pronësi të z. I.M., në datën 21.11.2014, me shënimin “Leje legalizimi nr. **, datë 18.04.2011 “. Referuar përshkrimit të pasurisë, rezulton.
- **Në bazë të Lejes së Legalizimit nr. ***, datë 18.04.2011**, objekt 3-kat, kati përdhe me sip. 140.9 m², kati i parë me sip. 154.7 m² kati i dytë me sip. 157.7 m². Rivlerësuar në shumën 48.873.347 lek, sipas mandatit datë **.2013.
- **Vërtetim nga dokument hipotekor nr. ***, datë 12.05.2011**, konfiguroni e regjistruar në pronësi të z. I.M., pasuria nr. **, Zk **, me sipërfaqe trualli 543 m² dhe sipërfaqe ndërtesë 140.9 m², me përshkrimin “*truall me sipërfaqe 543 m² mbi të cilën ndodhet një ndërtesë, godinë banimi 3-kate, me sipërfaqe 140.9 m², me adresë: Rruga Budi, Tiranë*”.
- **Kontratë kalimi të pronësisë të parcelës ndërtimore nr. ** rep., nr.** kol., datë 14.01.2011**, me blerës z. I.M dhe shitës Drejtoria Rajonale *** Tiranë, për kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore me sipërfaqe 543 m², të ndodhur në Njësinë Bashkiake **, pas pagesës së shumës 6.986.272 lek, për parcelën dhe shumës 63.792 lek, për taksën e ndikimit në infrastrukturë.
- **Mandat pagesa në Credins Bank**, datë 03.01.2011, për shumën 3.416.272 lek, nga z .I.M., me përshkrimin “*..pagesë për parcelën ndërtimore..* “. Formular i pagesës në LEK të parcelës ndërtimore nga ALUIZNI, për shumën 3.416.272 lek, nga vlera totale prej 6.986.272 lek.
- **Mandat pagesa në Credins Bank**, datë 03.01.2011, për shumën 63.792 lek nga z. I.M, me përshkrim “*..taksë ndikimi në infrastrukturë..* “. Formular i pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ALUIZNI, për shumën 63.792 lek, referuar vlerës së investimit: 450.3 1712 x 28.333 lek = 12.758.350 lek.
- **Mandat pagesa në Credins Bank**, datë 3.01.2011, për shumën 280.000 lek, nga z. I.M., me përshkrimin “*..ALUIZNI Tiranë, Bono Privatizimi..* “. Bashkëlidhur: Formular i pagesës me Bono Privatizimi të parcelës ndërtimore (me sip. 300 m² /vlerë 400.000 lek) nga ALUIZNI, për shumën 280.000 lek (70%).
- **Mandat pagesa në Credins Bank**, datë 3.01.2011, për shumën 3.290.000 lek, nga z. I.M., me përshkrimin “*..ALUIZNI Tiranë, Bono Privatizimi...*”. Formular i pagesës me

Bono Privatizimi të parcelës ndërtimore (me sip. 243 m² / vlerë 6.586.272 lek) nga ALUIZNI, për shumën 3.290.000 lek (50%).

- **ASHK (online), konfirmon pasurinë** nr. ***, vol. **, faqe **, Zk **, në pronësi të z. I.M., me status “aktive “ *dhe me përshkrim* “..sipas Lejes së Legalizimit nr. **, datë 18.04.2011. Objekt 3-kate: kati përdhe me sip. 140.9 m²; kati i parë me sip. 154.7 m²; kati i dytë me sip. 157.7 m². Rivlerësuar në datën 22.10.2013.

26. Në proces-verbalin e datës 17.05.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga

trupa e vlerësimit, subjekti paraqiti relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke sqaruar si burim financiar për blerjen dhe investimet në pasuritë e paluajtshme kanë shërbyer kursimet nga të ardhurat familjare, duke konfirmuar në çdo rast sipërfaqet e pasurive të paluajtshme, referuar dokumentacionit për vërtetim pronësie. Subjekti ka sqaruar se vlera 4.500.000 lek është deklaruar sipas vlerës së menduar të tregut në vitin 2004 (sipas deklaramit fillestar, për të cilin paraqet sqarime në vijim) duke konfirmuar vlerën e ndërtimit sipas tabelës përmbledhëse të vlerës së llogaritur të objektit, në shumën 2.935.043 lek, si dhe duke sqaruar se ndërtimi i godinës pjesë-pjesë, ka zgjatur ndër vite dhe për këtë arsye nuk disponohet dokumentacion i plotë lidhur me vlerën e shpenzuar. Gjithashtu, subjekti ka konfirmuar se vlera e paguar për blerjen e truallit në procesin e legalizimit është sipas kontratës datë 14.01.2011, e likuiduar në shumën monetare 3.416.272 lek, sipas mandat pagesës datë 03.01.2011 dhe diferenca nëpërmjet pagesave me bono privatizimi, sipas mandatë pagesave datë 03.01.2011.

Lidhur me pagesat me bono privatizimi, subjekti ka sqaruar se bonot i kanë disponuar pjesërisht në familje dhe i ka përfituar nga njerëz të afërt, për të cilat, për shkak të marrëdhënieve të posaçme familjare, nuk disponon dokumentacion vërtetues lidhur me përfitimin dhe vlerën monetare të tyre, duke konfirmuar sipas dokumentacionit të paraqitur, si dhe duke sqaruar se vlera e bonove të privatizimit duhet të jetë diferenca nga vlera e deklaruar me vlerën e paguar në lek. Subjekti ka sqaruar se deklarimi është kryer sipas sipërfaqes së truallit dhe sipërfaqes së bazës ndërtimore, duke konfirmuar sipërfaqen totale të ndërtimit sipas konfirmimit dhe sipas dokumentacionit të paraqitur (lejes së legalizimit dhe kartelës së pasurisë) duke saktësuar se nuk disponon dokumentacion shtesë, lidhur me aplikimet e kryera për legalizim, si dhe duke sqaruar se nuk disponon informacion lidhur me vlerën e pasurisë së llogaritur nga Aluiznit (duke konfirmuar vlerën sipas dokumentacionit të paraqitur), si dhe duke saktësuar se pjesa takuese e pasurisë është deklaruar sipas regjimit martesor.

27. Me inventarin nr. * prot., datë 30.04.2024, subjekti ka dorëzuar:**

- **Relacion nga z. I.M.**, ku ka sqaruar se “...godina 3-katëshe është ndërtuar ndër vite nga ana e tij dhe familjarëve, duke filluar nga viti 1992 deri në vitin 2004, me burim financiar nga kursimet familjare. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se vlera 4.500.000 lek është vlera e tregut në vitin 2004, ndërkohë që vlera e ndërtimit është 2.935.043 lek, sipas preventivit të përgatitur mbi bazën e çmimeve të referencës.”

- **Raport vlerësimi datë 20.10.2013, për pasurinë nr. ****, me sipërfaqe trualli 543 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 450.3 m², të ndodhur në adresën: ***, Nr. ***, Njësia **, Tiranë. Vlera e tregut: 48.873.345 lek. Tatimi për t “u paguar: 218.925 lek.
- **Mandat pagesa në Credins Bank**, datë 22.10.2013, për shumën 218.926 lek.
- **Vlerësim për mobilim prone, datë 17.03.2024**, për pasurinë nr. ***, vol. **, faqe ***, zk ***, e llojit truall me sip. 543 m² dhe ndërtesë 3-kate me sip. baze 140.9 m², të ndodhur në Rr. ***, Tiranë. Vlera totale e mobilimit: 2415.900 lek. Fotografi të ambienteve të jashtme dhe të brendshme të pasurisë së paluajtshme.
- **Tabelë përmbledhëse e vlerës së llogaritur të objektit** (preventiv i çmimeve të referencës), rezultuar me vlerë 2.935.043 lek.

28. Në proces-verbalin e datës 17.05.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka saktësuar se paraqet relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke sqaruar se e gjithë procedura e kryer fillimisht për hipotekimin e shtëpisë (së bashku me praktikën e dokumenteve) nuk kanë pasur vlerë juridike në vijim, pas aplikimit për legalizim dhe marrjes së lejes së legalizimit.

29. Me inventarin nr. * prot., datë 17.05.2024, subjekti ka dorëzuar:**

- **Relacion nga Ilirjan Mandro**, ku ka sqaruar se vlerësimi i banesës është kryer sipas çmimeve të periudhës së ndërtimit 1994 - 2004 (e ndërtuar në vazhdimësi). Gjithashtu, ka sqaruar se “... *procesi i njohjes së pronësisë ka nisur prej vitit 1992, kur kërkesa e tij për ndërtim është dakordësuar nga Komiteti Ekzekutiv i ***, “për dhënie trualli për ndërtim” dhe përplotësim dokumentacioni kërkohej edhe dakordësia e Drejtorisë së Qytetit Studenti, ku me kërkesën e datës ***.1996 është dakordësuar ndërtimi sipas kthim përgjigjes, datë ***.1996..*”. Në përfundim të këtij procesi, subjekti ka sqaruar se “...*legjislacioni i kohës njihte procesin e “vërtetimit të faktit” dhe me vendimin gjyqësor nr.*** akti, datë **.1997 është vendosur vërtetimi i faktit juridik i ndërtimit të një shtëpie në pronësi të z. I.M, duke marrë formë të prerë në datën 25.04.1997. Në vijim, me qëllim hipotekimin e banesës (e cila ishte e papërfunduar), subjekti ka sqaruar se është kryer veprimi juridik i dhurimit në favor të nënës së tij C.M, pasi vetëm kështu mundësohej procesi i hipotekimit, për të cilin duke mos pasur asnjëherë një përgjigje, u aplikua në procesin e legalizimit sipas praktikës së përcaktuar në legjislacion..*”.
- **Situacion nga vlerësues L.I**, për shtëpinë e banimit, sipas çmimeve të periudhës së ndërtimit 1994 - 2004, rezultuar me vlerë 2.935.043 lek.
- **Vendim i Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. *** akti, datë 10.04.1997**, me kërkuar z. I.M dhe objekt: Vërtetim fakti juridik, ku është vendosur pranimi i kërkesës dhe vërtetimi i faktit juridik të ndërtimit të një shtëpie banimi 2-kate nga z. I.M., në Tiranë.
- **Kërkesë me shkrim datë 20.04.1992**, drejtuar Komitetit Ekzekutiv të Rajonit nr. ** Tiranë, nga z. I.M., për dhënien e një sipërfaqe trualli prej 300 m² për ndërtim shtëpie.
- **Kërkesë datë 05.07.1996**, drejtuar Drejtorisë së Q.S, nga z. A.dhe I.M, si banorë 10-vjecarë të Q.S të strehuar në godinën nr. **, për ndërtimin e një godine multi funksionale sipas planimetrisë.

- **Kthim** përgjigje nga Ndërmarrja Tregtare TS nr **, me nr. ** prot., datë 11.10.1996, për dakordësinë e kërkesës për ndërtimin e një godine poli funksionale, për të cilën dhënia e lejes së ndërtimit është një kompetencë të Bashkisë Tiranë.
- **Vërtetim nr. ** prot., datë 03.06.1996**, për dhënien e lejes së ndërtimit nga z. I.M. të një banese private 2-kate, sipas planimetrisë, në Rr.**.
- **Kontratë dhurimi nr. **** rep., nr. ** kol.**, datë 09.05.1997, me dhurues z. I.M. dhe pranues dhurimi znj. C.M, për dhurimin e një shtëpie banimi 2 kate + ambient papafingo, të ndodhur në Rr. **, Tiranë, pa kundër shpërblim.

30. Konkluzion:

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur në lidhje me pasurinë e paluajtshme me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 543 m², sipërfaqe baze ndërtimi 140.9 m², dhe sipërfaqe totale ndërtimi 453.3 m² për banim. Ky objekt është ndërtuar nga subjekti gjatë periudhës 1992 - 2004, me vlerë investimi të deklaruar/dokumentuar rreth 2.935.000 lekë, me burim financiar kursime nga të ardhurat familjare të kësaj periudhe. Është deklaruar sipas vlerës së menduar të tregut në vitin 2004, me vlerë 4.500.000 lekë. Prona është legalizuar në vitin 2011, duke shtuar edhe vlerën e blerjes së truallit nga ALUIZNI, për shumën totale të paguar në vlerë monetare rreth 3.491.400 lekë dhe e rivlerësuar në vitin 2013, me vlerë 48.873.347 lekë.
- ✓ Subjekti ka kryer shpenzime për pagesa të detyrimeve tatimore lidhur me rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme në vlerën totale rreth 219.000 lekë, si dhe ka kryer shpenzime për mobilimin e banesës, me vlerë totale rreth 2.415.900 lekë.

Pasuria nr. 2

- ✚ Apartament me sipërfaqe 83 m² në Vlorë, në bashkëpronësi me bashkëshorten, sipas kontratës së shitjes datë 29.12.2012. Regjistruar në ZVRPP Vlorë: vërtetim pronësie datë 24.01.2013, certifikate pronësie datë 13.07.2015.

Burimi i krijimit: Kursime familjare nga të ardhurat e krijuara ndër vite. Vlera:72.000 euro. Zotëron 50%.

- ✚ Garazh me sipërfaqe 18 m² në Vlorë, në bashkëpronësi me bashkëshorten, sipas kontratës së shitjes datë 29.12.2012. Regjistruar në ZVRPP Vlorë, me vërtetim pronësie datë 24.01.2013 dhe certifikate pronësie datë 13.07.2015.

Burimi i krijimit: Kursime familjare. Vlera: 750.000 lek. Zotëron 50%.

Bashkëlidhur praktikës:

- **Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ******, lëshuar në datën 13.07.2015, për pasurinë nr. ****, vol. **, faqe **, Zk **, e llojit apartament me sipërfaqe 83 m², me adresë: Rr. **, Hyrja****, Apartamenti **, Vlorë; regjistruar në bashkëpronësi të z. I.M dhe znj. A.M.

- **Vërtetim nga dokumentet hipotekore datë 24.01.2013**, ku vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. **, datë 24.01.2013, figuron i regjistruar në bashkëpronësi të z.I.M. dhe A. M., pasuria nr. **, Zk **, me sipërfaqe 83 m², në adresën: **, Vlorë; Nga Objekt ** me 2 kate dyqane dhe 1 kat parkim nëntokë. Një apartament me sipërfaqe 83 m², nga kjo sipërfaqe ballkoni 10 m². Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.2012, me blerës z. I.M dhe znj A.M., shitës shoqëria “***” shpk, për blerjen e apartamentit nr. ** me sipërfaqe 83 m², nga të cilat sip. ballkoni 10 m², të ndodhur në objektin nr. **, kati **-të, shkalla **, në Lagjen ** Vlorë. Vlera 5.000.000 lek, e likuiduar.
- **Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, lëshuar në datën 13.07.2015, për pasurinë nr. **, vol. **, faqe **, Zk **, e llojit garazh me sipërfaqe 18 m², me adresë: Rruga **, hyrja **, Vlorë; regjistruar në bashkëpronësi të z. I.M. dhe znj. A.M.
- **Kartela e pasurisë nr. ****, vol. ***, faqe **, Zk **, e llojit garazh me sipërfaqe 18 m², me adresë: Rr.**, Shkalla ***, Vlorë; regjistruar në bashkëpronësi të z. I.M. dhe znj. A.M., në datë 9.07.2015.
- **Vërtetim nga dokumentet hipotekore, datë 24.01.2013**, ku vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. ** datë 24.01.2013, figuron i regjistruar në bashkëpronësi të z. I.M. dhe znj. A.M., pasuria nr. **, Zk **, me sipërfaqe 18 m², në adresën: L. ** Vlorë; Nga Objekt ** kate me 2 kate dyqane dhe 1 kat parkim nëntokë. Një garazh me sipërfaqe 18 m².
- **Kontratë shitje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 29.12.2012**, me blerës z. I.M. dhe znj. A.M., shitës shoqëria “***” shpk, për blerjen e Vend Parkimit nr. * me sipërfaqe 18 m², të ndodhur në objektin nr. ***, kati nëntokësor, në Lagjen **, Vlorë. Vlera 750.000 lek, e likuiduar.
- **Tirana Bank me shkresën nr. ** prot., datë 14.08.2023**, konfirmon se në llogari të znj. A.M. rezulton: kreditimi cash i shumës 21.500 euro dhe debitimi me transfertë i shumës 21.500 euro, me përshkrim “*banesë/garazh, kësti 2-të sipas kontratës*”, në datë 19.06.2009.
- **ASHK (online), konfirmon pasurinë nr. **, vol. ***, faqe **, Zk ***, dhe pasurinë nr. ***, vol.**, faqe**, Zk **, në bashkëpronësi të z. I.M. dhe znj. A.M., me status “aktive“, të ndodhura në Vlorë.**

31. Në proces-verbalin e datës 30.04.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke e sqaruar, se si burim financiar për blerjen dhe investimet në pasuritë e paluajtshme kanë shërbyer kursimet nga të ardhurat familjare, si dhe duke konfirmuar në çdo rast sipërfaqet e pasurive të paluajtshme referuar dokumentacionit për vërtetim pronësie. Subjekti ka sqaruar se nga vlera e apartamentit prej 72.000 euro: në datë 13.06.2009 është likuiduar shuma 55.000 euro sipas dokumentacionit të paraqitur; në datë 19.06.2009 është likuiduar shuma 14.000 euro (nga totali i transfertë prej 21.500 euro në Tirana Bank); dhe diferenca prej 3.000 euro, nuk është likuiduar për shkak të vonesës në kryerjen e punimeve, sipas dokumentacionit të paraqitur (duke u konsideruar i anuluar si detyrim). Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se apartamenti është marrë në dorëzim me punime të papërfunduara dhe punimet janë kryer në vazhdimësi nga firma, sipas preventivit të paraqitur, duke deklaruar se nuk janë kryer veprime të dokumentuara për marrjen në dorëzim të

apartamentit me punime të përfunduara, si dhe nuk është përdorur për qëllime fitimi. **Lidhur me garazhin**, subjekti ka saktësuar se kthimi i shumës 240.000 lek (nga diferenca e vlerës së garazhit 750.000 lek prej shumës së paguar prej 7.500 euro) është kryer cash. Në vijim, subjekti ka konfirmuar se vlera totale e paguar për blerjen e apartamentit është 69.000 euro dhe vlera totale e paguar për blerjen e garazhit është 750.000 lek (kthyer shuma 240.000 lek nga vlera e paguar fillimisht prej 7.500 euro), duke sqaruar se kontrata e shitjes përfundimtare për apartamentin është kryer me vlerë 5.000.000 lek, sipas gjendjes faktike të asetit në momentin e lidhjes së kontratës.

Me inventarin nr. ** prot., datë 30.04.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Relacion nga z. I.M.**, ku ka sqaruar se, sipas kontratës së porosisë, apartamenti duhej të përfundonte dhe dorëzohej në datë 31.12.2010, por për shkak se punimet e ndërtuesit vonuan përtej afateve të parashikuara, kanë lidhur një akt-marrëveshje, në datën 28.10.2012, me ndërtuesin, Shoqëria “***” shpk, e cila i bashkëlidhej kontratës me nr. ** rep, nr. *** kol, datë 13.06.2009, ku palët për shkak të vonesave të punimeve të brendshme të apartamentit dhe pamundësisë për të përfunduar sipas afateve kontraktore, kanë rënë dakord që të lidhin kontratën e shitjes në gjendjen që ishte ndërtimi, me kushtin që shoqëria të kryejë punimet e mbetura të parashikuara, brenda një periudhe sa më të shkurtër, por jo më vonë se dy vjet nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje dhe në llogaritjen e vlerës së kontratës së shitjes, shoqëria ndërtuese merrte përsipër të zbrisë nga shuma totale e kontratës paraprake edhe penalitetet që kishte ndaj palës blerëse, për shkak të vonesës në dorëzimin në kohë të apartamentit në shumën 200 euro për çdo muaj vonesë, sipas pikës 13 të nenit "Të drejtat e detyrimet e palëve" si dhe këstin prej 3000 euro që ishte parashikuar të likuidohej me dorëzimin e certifikatës së pronësisë. Nisur nga sa më sipër, subjekti ka sqaruar se vlera e apartamentit në kohën e lidhjes së kontratës së shitjes, në datë 29.12.2012 ishte 5.000.000 lek dhe diferenca e punimeve të papërfunduara ka qenë rreth 3.400.000 lek dhe për të provuar punimet e kryera, bashkëlidhur preventivin përkatës të përgatitur nga vlerësuese Ing. A.C. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit garazh, subjekti ka sqaruar se në kontratën paraprake është parashikuar blerja e një garazhi me sipërfaqe 36 m², ndërkohë që mbas akt-marrëveshjes u ra dakord që garazhi të përfitohej në sipërfaqen 18 m², me vlerë 750.000 lek dhe në pagesën paraprake të datës 19.06.2009, është përfshirë dhe shuma 7.500 euro për garazhin me sipërfaqe 36 m², nga e cila për shkak të uljes së sipërfaqes së garazhit, kompania ndërtuese ka kthyer shumën prej 240.000 lek.

Bashkëlidhur praktikës:

- **Kontratë paraprake shit-bleje nr.** rep., nr. ** kol.**, datë 13.06.2009, me blerës z. I.M. dhe znj. A.M., me shitës shoqëria ** shpk, për shitjen e apartamentit nr. ***, me sipërfaqe ndërtimi 95.6 m², të ndodhur një objektin nr. * kati *, shkalla **, Vlorë. Vlera 72.000 euro, nga të cilat shuma 55.000 euro likuidohet sot një datë 13.06.2009, kësti i dytë me vlerë 14.000 euro do të likuidohet deri një datë 20.06.2009 dhe kësti i tretë me vlerë 3.000 euro do të likuidohet me dorëzimin e certifikatës së pronësisë.

- **Mandat pagese nga ** shpk, datë 13.06.2009**, për likuidimin nga z. I.M. të kështit të parë në shumën 55.000 euro, nga vlera e apartamentit prej 72.000 euro.
- **Akt-Marrëveshje datë 28.10.2012**, me palë I.M. dhe shoqëria *** shpk, ku deklarohet se për shkak të vonesave në punimet e brendshme të apartamentit të porositur sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.06.2009 (apartamenti i cili duhej të dorëzohej i përfunduar në datën 31.12.2010) palët bien dakord që të lidhin kontratën e shitjes në gjendjen që ishte ndërtimi me kushtin që shoqëria të kryejë punimet e mbetura, jo më vonë se dy vjet nga nënshkrimi i kësaj aktmarrëveshje, si dhe në llogaritjen e vlerës së kontratës shoqëria ndërtuese merr përsipër të zbresë nga shuma totale e kontratës paraprake penalitetet që kishte ndaj palës blerëse, si dhe kështin prej 3.000 euro i parashikuar për t'u likuiduar me dorëzimin e certifikatës së pronësisë.
- **Relacion lidhur me preventivin e punimeve të pakryera** nga Ing. Y.M, rezultuar me vlerë 3.400.024 lek.
- **Vlerësim për mobilim apartamenti** datë 04.03.2024, për pasurinë nr. **, vol **, faqe **, zk **, e ndodhur në Vlorë. Vlera totale e mobilimit: 921.000 lek. Bashkëlidhur praktikës: Fotografi të ambienteve të brendshme të pasurisë së paluajtshme.

32. Në proces-verbalin e datës 17.05.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke sqaruar se vlera e dakordësuar fillimisht për blerjen e garazhit me sip. 36 m² ka qenë 10.000 euro (sipas dokumentacionit të disponuar aneks kontratës), nga të cilat janë likuiduar 7.500 euro sipas sqarimeve; dhe në vijim, duke qenë se kanë ndryshuar kushtet e marrëveshjes, është blerë garazh me sip. 18 m², me vlerë 750.000 lek (duke përfituar cash diferencën prej 240.000 lek nga shuma e paguar).

Me inventarin nr. ** prot., datë 17.05.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Relacion nga z. I.M**, ku ka sqaruar se vlera e garazhit prej 750.000 lek (nga vlera fillestare prej 10.000 euro) është rezultat i sipërfaqes më të vogël (18 m²) të përcaktuar në kontratën e shitjes nga sipërfaqja e përcaktuar në kontratën paraprake (36m²). Bashkëlidhur praktikës:
- **Aneks Kontrate** (bashkëlidhur kontratës paraprake të shitblerjes së sendit të ardhshëm e lidhur në datë 13.06.2009), me blerës z. I.M. dhe znj. A.M., me shitës ** shpk, për vend parkimin me sipërfaqe 36 m², me vlerë 10.000 euro e cila do të likuidohet deri në datën 20.06.2009.

33. Konkluzion:

- ✓ Konfirmohet deklarimi me e dokumentacionin e paraqitur për apartamentin e porositur nga subjekti dhe bashkëshortja në vitin 2009, me vlerë të dakordësuar 72.000 euro, të likuiduar në shumën totale 69.000 euro, në vitin 2009 me burim financiar, kursimet nga të ardhurat familjare dhe është marrë në dorëzim me punime të papërfunduara në vitin 2012 ku duke zbritur nga vlera e dakordësuar shumën 3.000 euro, për shkak të vonesave në kryerjen e punimeve, duke disponuar aktualisht mobilimin, me vlerë totale, rreth 921.000 lekë.

Pasuria nr. 3

- 🏠 Apartament banimi me sipërfaqe 37.7 m², në Vlorë, regjistruar në ZVRPP, në datë 25.01.2022, në bashkëpronësi me bashkëshorten. Përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave në datën 20.08.1993 nga nëna, paguar shuma 2.428 lek dhe rivlerësuar (është paguar aplikimi në vlerën 47.923 lek).

Burimi i krijimit: Trashëgimi nga nëna. Vlera: 0 lek. Zotëron 66.67 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Certifikatë regjistrimi pronësie** lëshuar në datën 25.01.2022, për pasurinë nr. ***, zk ***, e llojit apartament me sipërfaqe 37.7 m², të ndodhur në Vlorë, regjistruar në bashkëpronësi të Ilirjan Kadri Mandro me pjesë takuese 2/3.
- **Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore** nr. *** rep., nr. *** kol.datë 22.09.2021, me trashëgimlënës C. J. Mandro dhe trashëgimtar Ilirjan Kadri Mandro.

34. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **ASHK (online), konfirmon pasurinë** nr. **, vol. *, faqe **, zk **, në bashkëpronësi të z. I.M. dhe znj. A.M., me status “aktive“, e ndodhur në Vlorë.

35. Në proces-verbalin e datës 30.04.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke sqaruar se si burim financiar për blerjen dhe investimet në pasuritë e paluajtshme kanë shërbyer kursimet nga të ardhurat familjare.

Subjekti ka sqaruar se për pasurinë është aplikuar për rivlerësim dhe nuk ka përfunduar procedura nga ASHK, duke saktësuar se nuk janë kryer investime për pasurinë e paluajtshme, e cila është dhënë me qira për një periudhë kohore maj 2013 - mars 2018, me vlerë rreth 7.000 lek/muaj, duke përfituar të ardhurat sipas transaksioneve bankare dhe për të cilën detyrimet janë dakordësuar që të likuidohen nga pala qiramarrëse, duke sqaruar se për shkak të kohës së kaluar dhe përfundimit të marrëdhënies së qirasë, nuk disponon dokumentacion shtesë. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se pjesa takuese e pasurisë është deklaruar sipas certifikatës familjare, në momentin e përfitimit dhe në vijim sipas trashëgimisë ligjore, ku ai disponon 1/3 pjesë takuese si anëtar i familjes dhe 1/3 pjesë takuese si trashëgimtar ligjor i nënës znj. C.M ndërsa bashkëshortja disponon 1/3 pjesë takuese, si anëtare e familjes në momentin e privatizimit.

Me inventarin nr. ** prot., datë 30.04.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Kontratë privatizimi datë 20.08.1993**, lidhur midis palës NKB dhe palë qiramarrëse znj. C.M, për apartamentin **, me vlerë 2.428 lek. Bashkëlidhur praktikës: Certifikatë familjare me kryefamiljar znj.C.M, dhe anëtarë z.I.M (i biri), znj. A.M. (e reja) dhe A.M (nipi).
- **Mandatpagese në Credins Bank, datë 16.12.2021**, për shumën 42.724 lek të paguar nga z. I.M. në favor të D V ASHK Vlorë, me përshkrimin “.. rivlerësim pasurie e paluajtshme”

- **Vlerësim për mobilim apartamenti**, datë 17.03.2024, për pasurinë nr. **, zk**, e llojit apartament, e ndodhur në Vlorë. Vlera totale e mobilimit: 65.000 lek. Fotografi të ambienteve të brendshme të pasurisë së paluajtshme.
- **Deklaratë me shkrim dore nga shtetasja D.J.**, e cila deklaron se merr me qira apartamentin e shtetasit z. I.M., të ndodhur në Vlorë, për periudhën maj 2013 dhe në vijim, duke marrë përsipër të shlyejë të gjitha detyrimet ndaj shtetit, si dhe qiranë me vlerë 7.000 lek/muaj.

36. Në proces-verbalin e datës 17.05.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke sqaruar se ka deklaruar apartamentin, si të përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave, e konsideruar si të barasvlershëm me NK Banesa, duke konfirmuar se ka kryer pagesat për rivlerësim të pasurisë (për të cilën nuk ka përfunduar procesi).

Me inventarin nr. ** prot., datë 17.05.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Relacion nga z. I.M.**, ku ka sqaruar se pas marrjes së certifikatës së regjistrimit të pronës, është bërë kërkesë për rivlerësim të banesës duke kryer edhe pagesat përkatëse sipas tarifave të përcaktuara, për të cilat vlera e rivlerësimit nuk është pasqyruar në dokument hipotekor nga ana e institucionit.
- **Kërkesë për rivlerësim datë 06.12.2021** drejtuar ZVRPP Vlorë nga klienti z. I.M.
- **Mandat pagesa në Credins Bank** datë 16.12.2021, për shumën e paguar prej 42.224 lek, nga z. I.M në favor të” ASHK Vlorë, me përshkrimin “..rivlerësim pasurie..”
- **Certifikatë regjistrimi pronësie** lëshuar në; datën 25. I.2022, për pasurinë nr. ** zk **, e llojit apartament me sipërfaqe 37.7 m², të ndodhur në; Vlorë, regjistruar në bashkëpronësi të znj. A.M. me pjesë takuese 1/3.

37. Konkluzion:

- ✓ Apartamenti me sipërfaqe 37.7 m² është privatizuar nga privatizimi i ish-banesave shtetërore me pjesë takuese 1/3 secili, nga nëna e subjektit, subjekti dhe bashkëshortja e tij në vitin 1993, me vlerë 2.428 lekë dhe në vijim është përfituar nga trashëgimia ligjore e nënës së tij. Është aplikuar për rivlerësim pasurie, duke paguar detyrimet tatimore me vlerë 42.724 lekë. Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur.

Pasuria nr. 4

- 🏠 Apartament banimi me sipërfaqe 71 m², me adresë: **, Vlorë, në bashkëpronësi me bashkëshorten, sipas kontratës datë 30.01.2016. Regjistruar në ZVRPP Vlorë, në datën 10.02.2016.

Burimi i krijimit: Kursime familjare. Vlera: 45.840 euro. Zotëron 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Certifikatë për vërtetim pronësie** nr. **, lëshuar në datën 10.02.2016, për pasurinë nr. **, vol. **, faqe **, zk **, e llojit apartament me sipërfaqe 71 m², me adresë: Rr.**,

Godina **, Hyrja **, Apartamenti **, Vlorë; regjistruar në bashkëpronësi të z.I.M. dhe znj. A.M.. Kartela e pasurisë nr. **, vol. **, faqe **, zk **, e llojit apartament me sipërfaqe 71 m², me adresë: Rr. **, Godina **, Shkalla. **, Kati **, Ap. **, Vlorë; regjistruar në bashkëpronësi të z.I.M. dhe znj. A.M., në datë 08.02.2016, “..për shumën e paguar 45.840..kontratë shitje.. “.

- **Kontratë shitje nr. ** rep. , nr. ** datë 30.01.2016**, me blerës z.I.M. dhe znj. A.M., shitës shoqëria “**“ shpk dhe shoqëria “**” shpk, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 71 m², nga kjo 8.5 m² ballkon, me nr. pasurie **, vol. **, faqe **, shkalla **, kati **, Ap. **, zk **, Vlorë. Vlera 45.840 euro, e likuiduar.

38. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **ASHK (online), konfirmon pasurinë** nr. **, vol. **, faqe **, zk **, në bashkëpronësi të z.I.M. dhe znj. A.M., me status “aktive“, e ndodhur në Vlorë.

39. Në proces-verbalin e datës 30.04.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke sqaruar se si burim financiar për blerjen dhe investimet në pasuritë e paluajtshme kanë shërbyer kursimet nga të ardhurat familjare. Gjithashtu, subjekti ka konfirmuar se shuma 45.840 euro është shlyer cash, duke konfirmuar se pasuria e paluajtshme nuk është përdorur për qëllime fitimi.


Me inventarin nr. ** prot., datë 30.04.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Kontratë porosie** për ndërtim apartamenti datë 28.07.2007, me palë porositëse z.I.M. dhe znj. A.M., me ndërtues shoqëria ** shpk, për apartamentin me sipërfaqe totale 77.7 m², me vlerë 45.840 euro, e cila do të likuidohet sot në vlerën totale.
- **Vlerësim** për mobilim apartamenti, datë 12.03.2024, për pasurinë **, zk **, e llojit apartament, i ndodhur në Vlorë. Vlera totale e mobilimit: 509.000 lek. Fotografi të ambienteve të brendshme të pasurisë së paluajtshme.
- **Relacion nga Ilirjan Mandro**, ku ka sqaruar se pagesa për blerjen e apartamentit është kryer cash, nga të cilat pjesa më e madhe është paguar menjëherë dhe diferenca në vazhdimësi të punimeve, me burim financiar nga të ardhurat familjare ndër vite, dhe për të cilat nuk ka mundur të disponojë dokumentacion të saktë nga ndërtuesi (z. L.LL).
- **Subjekti** ka deklaruar shpenzime mobilimi me vlerë rreth 509.000 lek.

40. Konkluzion:

- ✓ Apartamenti me sipërfaqe 71 m², është blerë nga subjekti dhe bashkëshortja me vlerë të dakordësuar 45.840 euro, të likuiduar për periudhën 2007 - 2016 me burim financiar kursimet nga të ardhurat familjare, duke disponuar aktualisht mobilimin me vlerë totale rreth 509.000 lekë. Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur.

PASURI TË LUAJTSHME

-  Automjet Mercedes Benz E 220 CDI, vit prodhimi 2006, blerë në datën 05.02.2015 në bashkëpronësi me bashkëshorten sipas kontratës noteriale. Data e regjistrimit: 05.02.2015.

Burimi i krijimit: Kursime familjare. Vlera: 7.000 euro. Zotëron 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kontratë shitblerje nr. **rep., nr. **kol., datë 05.02.2015**, me blerës z.I.M. dhe znj. A.M., shitës z. L.S., për blerjen e automjetit tip Mercedes-Benz E 220 CDI me nr. shasje **, vit prodhimi 2006. Vlera 7.000 euro.


41. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **DPSHTRR me shkresën nr. ** prot., datë 29.08.2023**, konfirmon se z.I.M. dhe znj. A.M., kanë të regjistruar në bashkëpronësi, mjetin me targë **.
- **Kontratë shitblerje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 05.02.2015**, me blerës z.I.M. dhe znj. A.M., shitës z. L.S., për blerjen e automjetit tip Mercedes-Benz E 220 CDI me nr. shasje **, vit prodhimi 2006. Vlera 7.000 euro.
- **Tirana Bank me shkresën nr. ** prot., datë 14.08.2023** konfirmon se në llogari të znj. A.M. rezulton kreditimi cash nga z.I.M., i shumës 7.000 euro dhe debitimi me transfertë i shumës 7.000 euro, në datë 06.02.2015, me përshkrimin “..për z. L.S., sipas kontratës nr. ** rep. , nr. ** kol., datë 05.02.2015...”.

42. Konkluzion:

- ✓ Subjekti dhe bashkëshortja e tij, kanë blerë automjetin tip Mercedes Benz, me targë **, me vlere 7.000 euro, me burim financiar kursimet nga të ardhurat familjare (*automjet të cilin subjekti e disponon edhe aktualisht në bashkëpronësi me bashkëshorten*).

Pasuria nr. 6

-  Automjet Ford Focus, vit prodhimi 2002. Data e regjistrimit: 25.03.2013. Data e transaksionit: 25.03.2013, sipas kontratës noteriale.

Burimi i krijimit: Kursime familjare. Vlera: 200.000 Lek. Zotëron 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kontratë shitblerje nr. ** rep., nr. **kol., datë 25.03.2013**, me blerës z.I.M. dhe z. A.M., shitës z. A.T, për blerjen e automjetit tip Ford Fokus me nr. shasje **, vit prodhimi 2002 Vlera 200.000 lek e likuiduar.

43. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **DPSHTRR me shkresën nr. **prot., datë 29.08.2023** konfirmon se z.I.M. dhe z. A.M. kanë të regjistruar në bashkëpronësi, mjetin me targë **.

- **Kontratë shitblerje nr.** rep., nr. ** kol., datë 25.03.2013**, me blerës z.I.M dhe z. A.M., shitës z. A.T për blerjen e automjetit tip Ford Fokus me nr. shasie **, vit prodhimi 2002. Vlera 200.000 lek.

44. Konkluzion:

- ✓ Subjekti dhe djali i tij, kanë blerë automjetin tip Ford Fokus, me targë **, me nr. shasie ** me vlerë 200.000 lek, me burim financiar kursimet nga të ardhurat familjare (*automjet të cilin subjekti e disponon edhe aktualisht në bashkëpronësi me djalin e tij*)

Pasuria nr. 7

- 🚦 Llogari (individuale) page në Tirana Bank. Me këtë llogari është e lidhur një kartë krediti, të cilën nuk e kam përdorur dhe nuk kam detyrime.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga, shpërblime, dieta dhe honorarë. Vlera: 2.403.345 lek. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Statement nga Tirana Bank** printuar në datën 02.11.2022, për llogarinë e z.I.M. me balancë 1.394.259 lek, në datën 15.10.2022, ku rezulton kreditimi i të ardhurave nga paga, për periudhën 01.01.2022 - 15.10.2022.

45. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Tirana Bank me shkresën nr. ** prot., datë 14.08.2023** konfirmon se në emër të z.I.M. rezulton llogari page me balancë 2.403.095 lek, në datën 03.04.2023 dhe 2.525.224 lek, në datën 27.04.2023. Referuar në statement bankar rezulton kreditimi i të ardhurave nga Universiteti i Vlorës, për periudhën 18.12.2009 - 18.10.2010; si dhe kreditimi i të ardhurave nga pagat shpërblimet dhe qiraja, për periudhën 06.01.2011 - 27.04.2023.

46. Në proces-verbalin e datës 30.04.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke sqaruar se si burim financiar për balancat e likuiditeteve bankare, kanë shërbyer kursimet nga të ardhurat familjare. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se pavarësisht të dhënave si lapsus në formën e gabimit material, në deklarinimin e datave të balancave dhe veprimeve bankare apo valutave, konfirmon sipas saktësimeve referuar dokumentacionit të paraqitur dhe përgjigjeve të institucioneve bankare.

47. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Tirana Bank, është krijuar gjatë periudhës 2009 - 2023.

Pasuria nr. 8

- 🚦 Llogari (shumë emërore) rrjedhëse në Credins Bank, në emrin tim dhe të vajzës.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga dhe bursa e vajzës. Vlera: 71.606 lek. Zotëron 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Statement nga Credins Bank**, printuar në datën 09.11.2022, për llogarinë në emër të z.I.M dhe znj A.M, me balancë 71.971 lek, në datën 15.10.2022.


48. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Credins Bank me shkresën nr. ** prot., datë 2.10.2023** konfirmon se në emër të z.I.M dhe znj. A.M., rezulton llogari dy emërore, me balancë 71.971 lek, në datë 27.04.2023. Referuar në statement bankar rezulton kreditimi me transfertë, i shumës 60.000 lek, në datën 15.06.2012 dhe kreditimi i interesave bankare me vlerë totale rreth 13.650 lek, për periudhën 15.06.2013 - 15.06.2022.

49. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Credins Bank, është krijuar gjatë periudhës 2012 - 2022.

Pasuria nr. 9

 Llogari (individuale) rrjedhëse në Credins Bank.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga puna. Vlera: 63 euro. Zotëron 100%.

50. Hetimi i trupës së vlerësimit


- **Credins Bank me shkresën nr. ** prot., datë 02.10.2023**, konfirmon se në emër të z.I.M, rezulton llogari rrjedhëse me balancë 63 euro, në datën 09.10.2022 dhe 544 euro, në datën 27.04.2023. Referuar në statement bankar rezulton kreditimi i të ardhurave nga paga dhe dietat, për periudhën I l. 6.2009 - 10.10.2022.

51. Në proces-verbalin e datës 30.04.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke sqaruar, se si burim financiar për balancat e likuiditeteve bankare, kanë shërbyer kursimet nga të ardhurat familjare. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se pavarësisht të dhënave si lapsus në formën e gabimit material në deklarinimin e datave të balancave dhe veprimeve bankare apo valutave, konfirmon sipas saktësimeve referuar dokumentacionit të paraqitur dhe përgjigjeve të institucioneve bankare.

52. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Credins Bank, është krijuar gjatë periudhës 2009 - 2022.

Pasuria nr. 10

 Llogari (individuale) rrjedhëse në Tirana Bank.

Burimi i krijimit: Kursime në vite. Vlera:3.344 euro. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Statement nga Tirana Bank, printuar në datën 02.11.2022, për llogarinë e z. I.M., me balancë 2.907 euro, në datën 15.10.2022.

53. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Tirana Bank me shkresën nr. ** prot., datë 14.08.2023**, konfirmon se në emër të I.M, rezulton llogari rrjedhëse me balancë 3.344 euro, në datën 31.12.2022 dhe 3.335 euro, në datën 27.04.2023. Referuar në statement bankar rezulton depozitime cash dhe kreditimi i të ardhurave nga dietat, për periudhën 17.12.2021 -28.12.2022.

54. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Tirana Bank, është krijuar gjatë periudhës 2021 - 2022.

Pasuria nr. 11

🇪🇺 Llogari (individuale) rrjedhëse në Bankën Kombëtare Tregtare.
Burimi i krijimit: Kursime nga pagat. Vlera: 409.994 lek. Zotëron 100%.

55. Hetimi i trupës së vlerësimit

- Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr. ** prot., datë 23.08.2023, konfirmon se në emër të z.I.M. rezulton llogari rrjedhëse: me balancë 409.994 lek, në datën 31.12.2022 dhe me balancë 409.394 lek, në datën 27.04.2023. Referuar në statement bankar rezulton kreditimi i të ardhurave, për periudhën 26.03.2010 – 06.04.2017.

56. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në BKT, është krijuar gjatë periudhës 2010 - 2017.

Pasuria nr. 12

🇪🇺 Llogari (individuale) rrjedhëse në Raiffeisen Bank.
Burimi i krijimit: Kursime ndër vite. Vlera: 5.053.121 lek. Zotëron 100%.


Bashkëlidhur deklaratës:

- **Statement nga Raiffeisen Bank** printuar në datën 25.10.2022, për llogarinë në emër të z. I.M., me balancë 5.053.656 lek, në datën 25.10.2022.
- **Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 10.08.2023**, konfirmon se në emër të z. I.M. rezulton llogari rrjedhëse me balancë 5.053.120 lek, në datën 27.04.2023. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi i pagesave në shumën totale rreth 57.000 lek, për periudhën 29.09.2014 - 28.12.2016, si dhe kreditimi cash i shumës 5.000.000 lek, në datën 3.05.2018, me përshkrimin “..I.M, të ardhura nga pagat, shpërblimet dhe projektet, tërhequr nga RZB..”.

57. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Raiffeisen Bank, është krijuar gjatë periudhës 2014 - 2016.

Pasuria nr. 13

 Llogari (individuale) depozitë në Tirana Bank.

Burimi i krijimit: Nga gjendja ekzistuese në llogarinë bankare në datën 13.06.2022. Vlera: 1.500.000 lek. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës.

- **Statement nga Tirana Bank**, printuar në datën 02.11.2022, për llogarinë e Ilirjan z.I.M., ku rezulton debitimi i shumës 1.500.000 lek, në datën 13.06.2022, me përshkrimin “*..Hapur depozite l-vjeçare..*”.
- **Statement nga Tirana Bank**, printuar në datën 02.11.2022, për llogarinë depozitë me afat në emër të z.I.M., me balancë 1.500.000 lek në datën 15.10.2022.

58. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Tirana Bank me shkresën nr. ** prot., datë 14.08.2023**, konfirmon se në emër të z.I.M. rezulton llogari depozitë me balancë 1.500.000 lek, në datën 27.04.2023. Referuar në statement bankar rezulton kreditimi i shumës 1.500.000 lek, në datën 13.06.2022, me përshkrimin “*..fillim depozite me afat..*”.

59. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Tirana Bank, është krijuar gjatë vitit 2022.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- **Të ardhura nga paga**, shpërblime, për periudhën 1984 - 1990, nga Policia Lezhë. Shënim: Në mungesë të dokumentacionit nga Policia Lezhë, deklarami është mbi bazën e të dhënave të përgjithshme të ruajtura nga unë. Shuma: 58.200 lek.
- **Të ardhura nga paga**, shpërblime, dieta, në Akademinë e Sigurisë sipas periudhave të ndryshme nga viti 1990 deri në mars 2023, sipas vërtetimit të lëshuar nga institucioni. Shuma: 17.822.713 lek.
- **Të ardhura nga paga**, shpërblime, për periudhën 16.06.1998 - mars 2001, në Institutin e Policisë Shkencore. Shënim: Në mungesë të dokumentacionit, deklarami është mbi bazën e të dhënave të përgjithshme të ruajtura nga unë. Shuma: 450.000 lek (me sa mbaj mend)
- **Të ardhura nga shitja e apartamentit** të ndodhur në Rr. ** Pallati **, Seksioni **, marrë nga EKB, sipas kontratës datë 29.09.1999. Shuma: 500.000 lek.
- **Të ardhura nga puna** për periudhën 2005 - 2011, paga në Policinë e Shtetit, trajnime, projekte, mësimdhënie etj., sipas vërtetimit të Raiffeisen Bank. Shuma: 7.134.994 lek.
- **Të ardhura si ekspert** Fondacioni **, dhjetor 2015-shkurt 2016. Shuma:141.000 lek.
- **Të ardhura nga paga**, shpërblime e të tjera shpenzime personeli, në Union Bank, për periudhën tetor 2009 - mars 2012, nga mësimdhënia. Shuma: 3.145.361 lek.

- **Të ardhura nga Fakulteti i Drejtësisë**, Universiteti i Tiranës, nga mësimdhënia për periudhat 1992 - 2000 dhe 2003 - 2004. Shuma: 447.800 lek + 18.000 lek (me sa mbaj mend).
- **Të ardhura nga Fakulteti i Drejtësisë**, Universiteti i Tiranës, nga mësimdhënia për periudhën 2007 - 2017. Shuma: 499.223 lek.
- **Të ardhura nga mësimdhënia në UET**, qershor 2009 - korrik 2017. Shuma: 8.910 euro.
- **Të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin Justiniani I**, sipas vërtetimit bankar për periudhën prill 2008 - gusht 2009. Shuma: 275.366 lek.
- **Të ardhura nga mësimdhënia Universiteti Justicia**, viti 2011. Shuma: 369.000 lek.
- **Të ardhura nga vendimi i gjyqit** në lidhje me pagesën e gradës shkencore, për periudhën mars 2001 - prill 2007. Shuma: 339.381 lek.
- **Të ardhura nga pensioni i nënës z. C.M.**, periudha 1976 - 2000. Shuma: 561.467 lek.
- **Të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin Marin Barleti**, për periudhën mars 2010 - tetor 2019. Shuma: 925.780 lek.
- **Të ardhura nga ekspertiza në Këshillin e Evropës, OSCE, European Initiative**, për periudhën qershor 2017 - prill 2019. Shuma: 3.769 euro.
- **Të ardhura nga ekspertiza në United Nations dhe Caritas Shqipëri**, për vitin 2016. Shuma: 2.452.228 lek.
- **Të ardhura nga qiraja e apartamentit**, për periudhën maj 2013 mars 2018, të paguara nëpërmjet sistemit bankar. Shuma: 504.000 lek.
- **Të ardhura nga mësim dhënien në Shkollën e Magjistraturës**, për vitin 2022 deri në datën e deklarimit. Shuma: 962.375 lek.
- **Të ardhura si pedagog i jashtëm në Universitetin e Vlorës dhe Fakultetin e Drejtësisë**, për periudhën 2016 - mars 2023 (sipas të dhënave bankare). Shuma: 1.851.612 lek.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kontratë shitje apartamenti banimi** me pagesë të menjëhershme, me blerës të përfaqësuar nga z.I.M dhe shitës EKB, datë 4.02.1999, për blerjen e apartamentit të banimit nr. **, të ndodhur në k.** shkalla **, banesa nr.** rruqa **, Tiranë, me sipërfaqe 57.96 m² (2+1+ambient ndihmës): me vlerë 1.280.050 lek, nga e cila 4% me vlerë 50.312 lek, likuidohet menjëherë. Vlera 757.900 lek, zbritet sipas VKM. Çmimi i shitjes është 601.408 lek dhe zbritet 30% me vlerë 165.329 lek sipas VKM. Blerësi pagoi shumën 407.133 lek, me faturën nr. *** datë 13.01.1999.
- **Mandat Arkëtimi** nr. ** datë 13.01.1999, për arkëtimin e shumës 407.133 lek, për blerje apartamenti.
- **Kontratë shitblerje** datë 20.06.1996, me shitës z.I.M. dhe blerës EKB, për shitjen e apartamentit me sipërfaqe 47.02 1712, të ndodhur në lagjen **, Rr. **, Pall. **, Shkalla. **, AP. **, Lezhë. Vlera 728.954 lek.
- **Proces-verbal** i vlerësimit të apartamentit, në çmimin e shitjes 757.900 lek.
- **Kontratë shitblerje** nr. ** rep., nr. ** kol., datë 26.02.1999, me blerës znj.C.M., z.I.M. dhe znj. A.M., me shitës EKB, D.R. Tiranë, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 57.96 m², të ndodhur në Rr.**Pallati**, Seksioni**, Apartamenti nr.** Kati** (2+1+ambiente

të tjera ndihmëse), kundrejt vlerës 407.133 lek, të likuiduar sipas mandat arkëtimit, nr. ** datë 13.01.1999.

- **Vërtetim nga ISSH (viti 2018)**, ku vërtetohet se znj.C.M. ka përfitur pension pleqërie, për periudhën 14.09.1976 - 26.04.2000, në shumën totale rreth 561.500 lek.
- **Tabelë e llogaritjes së gradës shkencore** të z. I.M., nga Akademia e Policisë, ku rezulton se sipas listë-pagesës së gradës shkencore, për periudhën 13.03.2001 - 01.04.2007, pagesa është në shumën totale bruto 377.090 lek dhe neto 339.381 lek.
- **Vendim nr. **, datë 04.12.2006**, i Gjykatës së Rr. Gj. Tiranë, me paditës z.I.M. dhe të paditur Akademia e Policisë “Arben Zylyftari”, ku është vendosur detyrimi i palës së paditur, të shpërblejë paditësin për titullin shkencor “Mjeshtër Kërkimesh” për periudhën 13.03.2001 - 28.01.2004 dhe në vazhdim për titullin “Profesor”
- **Vendim nr.** Akti., datë 14.02.2007**, për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për vendimin nr. **, datë 4.12.2006, të Gjykatës së Rr. Gjyqësor Tiranë.
- **Statement nga Tirana Bank**, printuar në datën 2.11.2022, për llogarinë e z.I.M. ku rezulton kreditimi i të ardhurave në shumën totale, rreth 1.585.000 lek për periudhën 01.01.2022 - 15.10.2022.
- **Statement nga Credins Bank**, printuar në datën 9.11.2022, për llogarinë e z.I.M. ku rezulton kreditimi i shumës 481 euro nga Këshilli i Evropës, në datën 10.10.2022.
- **Vërtetim nga Akademia e Sigurisë** nr. ** prot., datë 27.04.2023, ku vërtetohet se z.I.M. ka përfitur të ardhura neto në shumën totale 17.822.713 lek, për periudhën 1991-mars 2023.
- **Tabela përmbledhëse e të ardhurave**, ku rezulton se totali i të ardhurave për periudhën 1991 - 2005 është në vlerën rreth 4.435.000 lek.
- **Vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës**, nr. ** prot., datë 27.04.2023, ku vërtetohet se z. I.M. ka përfitur të ardhura neto në shumën totale 962.375 lek, për periudhën 2002 - 2022, nga të cilat shuma 15.159 lek, në vitin 2002 dhe shuma 16.020 lek, në vitin 2005.

60. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 10.08.2023**, konfirmon se në Llogari të z.I.M., rezulton kreditimi i të ardhurave nga pagat, dietat, shpërblimet dhe honorarët, në shumën totale rreth 863.000 lek, për periudhën 3.05.2005 - 31.12.2005 dhe në shumën totale rreth 5.597.000 lek, për periudhën 01.01.2006 - 31.12.2010. Gjithashtu konfirmon kreditimin e të ardhurave në shumën totale rreth 100.000 lek, për periudhën 21.03.2013 - 28.12.2016.
- **Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr. ** prot., datë 23.08.2023**, konfirmon se në llogari të z.I.M., rezulton kreditimi i të ardhurave nga paga dhe honorarë, në shumën totale rreth 1.065.000 lek, për periudhën 26.03.2010 - 06.04.2017.
- **Intesa San Paolo Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 21.09.2023**, konfirmon se në emër të z.I.M., rezulton llogari rrjedhëse në Euro, e mbyllur në datën 09.12.2008, llogari rrjedhëse në Usd, e mbyllur në datën 09.07.2008, si dhe llogari rrjedhëse në Lek, e mbyllur në datën 11.08.2009. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi i të ardhurave si pedagog nga Justiniani i Parë, në shumën totale rreth 273.000 lek, për periudhën 02.04.2008 - 25.07.2008.

- **Tirana Bank me shkresën nr. ** prot., datë 14.08.2023**, konfirmon se në llogari të z.I.M., rezulton kreditimi i të ardhurave nga dietat, në shumën totale rreth 991 euro, për periudhën 02.06.2022 - 28.12.2022.
 - **Konfirmon** se në llogari të Ilirjan Mandro, rezulton: kreditimi i të ardhurave nga Universiteti i Vlorës, në shumën totale rreth 223.760 lek, për periudhën 18.12.2009 - 18.10.2010; kreditimi i të ardhurave nga pagat dhe shpërblimet në shumën totale rreth 22.020.000 lek, për periudhën 06.01.2011 - 27.04.2023; si dhe kreditimi i të ardhurave nga qiraja, në shumën totale rreth 504.000 lek, për periudhën 10.05.2013 - 12.03.2018.
- **Credins Bank me shkresën nr. ** prot., datë 02.10.2023**, konfirmon se në llogari të z. I.M. rezulton: kreditimi i të ardhurave nga paga nga UET, në shumën totale rreth 3.600 euro, për periudhën 11.06.2009 - 02.11.2010 dhe në shumën totale rreth 5.310 euro, për periudhën 28.10.2013 - 29.09.2016, "kreditimi i të ardhurave nga paga dhe dietat, në shumën totale rreth 7.942 euro, për periudhën 08.05.2017 - 10.10.2022".
- **Union Bank me shkresën nr. ** prot., datë 07.09.2023**, konfirmon se në emër të z.I.M., rezulton llogari rrjedhëse në Lek, e mbyllur në datën 29.05.2013. Referuar në statement bankar rezulton kreditimi i të ardhurave nga pagat në shumën totale rreth 3.135.000 lek, për periudhën 30.10.2009 - 02.04.2012.
- **D.R.T. Tiranë me shkresën nr. ** prot., datë 25.08.2023** konfirmon se z.I.M, i ditëlindjes 30.08.1961, rezulton i regjistruar si individ privat me përgjegjësinë tatimore DIVA (deklarim individual vjetor i të ardhurave), për periudhën 2016 - 2022.
 - **DIVA 16-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 1.455.900 lek, të ardhura bruto nga qiraja 48.000 lek, të ardhura bruto të tjera 2.837.581 lek, në total në shumën 4.341.481 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 575.301 lek
 - **DIVA 17-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 1. 609.680 lek, të ardhura bruto nga qiraja 120.000 lek, të ardhura bruto të tjera 621.804 lek; në total në shumën 2.351.484 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 297.223 lek.
 - **DIVA 18-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 1.395.847 lek, të ardhura bruto nga qiraja 24.000 lek, të ardhura bruto të tjera 733.098 lek; në total në shumën 2.152.945 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 322.942 lek.
 - **DIVA 19-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 1.846.200 lek, të ardhura bruto të tjera 184.500 lek; në total në shumën 2.030.700 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 212.181 lek.
 - **DIVA 20-A**, ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 1.892.000 lek, të ardhura bruto të tjera 216.132 lek; në total në shumën 2.108.132 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 261.390 lek.
 - **DIVA 21-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 2.105.735 lek, të ardhura bruto të tjera 239.722 lek; në total në shumën 2.346.425 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 314.232 lek.
 - **DIVA 22-A**, ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 2.718.198 lek, të ardhura bruto nga interesat bankare 1. 889 lek, të ardhura bruto të tjera 145.200 lek; në total në shumën 2.865.287 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 407.611 lek.

- **ISSH me shkresën nr.**prot., datë 14.08.2023**, konfirmon se për z.I.M. janë paguar kontributet shoqërore dhe shëndetësore për pagën bruto dhe ka përfituar të ardhura nga paga neto: nga subjekti “Drejtorja e Përgjithshme e Policisë për periudhën janar 2012 - mars 2014; nga subjekti “U.E.T. “ për periudhën prill 2013 - qershor 2013,” nga subjekti “Qendra e Formimit Profesional/Akademia e Sigurisë “për periudhën shkurt 2014 - korrik 2023; nga subjekti “Universiteti Ismail Qemali Vlorë” në periudhën qershor 2015 - gusht 2022; nga subjekti “Fakulteti i Drejtësisë “ në periudhën shtator 2014 -janar 2016; nga subjekti “Caritas Shqiptar në periudhën dhjetor 2015 - janar 2017; nga subjekti “Fondacioni SEMA” në periudhën dhjetor 2015 - mars 2016; nga subjekti “Marin Barleti” në periudhën janar 2016 - prill 2017; nga subjekti “Shkolla e Magjistraturës” në periudhën dhjetor 2016 - dhjetor 2022.
- **ISSH me shkresën nr. ** prot., datë 14.08.2023**, i kërkon informacion Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, për të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur, për periudhën para vitit 2012.
- **ISSH, Drejtorja e Arkivit Qendror**, me shkresën nr. 54/30 prot., datë 24.08.2023, sqaron se për periudhën 1994 - 2012, nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave të punonjësve të siguruar në subjekte shtetërore, juridik, fizik, nuk mund të konfirmohet periudha kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, n.q.s. nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës për shtetasit për të cilët kërkohen të dhëna. Bashkëlidhur: Vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni.

61. Në proces-verbalin e datës 30.04.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke konfirmuar se pavarësisht gabimeve materiale në disa nga dokumentet e paraqitura, të ardhurat e realizuara janë referuar sipas dokumentacionit të paraqitur dhe transaksioneve bankare, duke shërbyer si burim financiar për krijimin e asetëve dhe përballimin e shpenzimeve familjare për jetesë, duke sqaruar se *“...aktualisht është objektivisht e pamundur të specifikohet burimi i të ardhurave për secilin kreditim bankar dhe konfirmuar se për të gjitha të ardhurat e kredituar dhe të deklaruar, janë paguar detyrimet, sipas përcaktimeve kontraktuale dhe ligjore, për të cilat nuk disponohet dokumentacion shtesë...”*.

Gjithashtu, subjekti ka sqaruar, se *“...duke deklaruar dhe paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me transaksionet e shit-blerjeve të pasurive është menduar i ezauruar detyrimi për deklarim të asetëve, të krijuara dhe tjetërsuara veçmas, si dhe duke saktësuar se pavarësisht citimit si gabim material të emrit të tij në disa nga kontratat dhe dokumentacionin e paraqitur, konfirmon transaksionet e referuara në secilin nga këto dokumente....”*.

Subjekti, sqaroi se fillimisht kanë disponuar një shtëpi në Lezhë (për të cilën nuk disponon dokumentacion shtesë), e cila është dorëzuar sipas parashikimeve ligjore (referuar dokumentacionit të paraqitur) para blerjes nga Enti Kombëtar i Banesave të një shtëpie në Tiranë me vlerë 407.133 lek (e llogaritur si diferencë vlerash nga EICB), banesë kjo, e cila është shitur me vlerë 500.000 lek, sipas dokumentacionit të paraqitur. Gjithashtu, subjekti

ka sqaruar se tatimi në burim, lidhur me të ardhurat, është deklaruar dhe paguar sipas deklaratave të ardhurave vjetore DIVA.

Me inventarin nr. extra prot., datë 30.04.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Relacion nga z.I.M.**, ku ka sqaruar se deklarimi i të ardhurave është bërë duke pasur në konsideratë institucionin nga kanë buruar të ardhurat dhe jo Llogarite bankare, ku mund të kenë kaluar, ndërkohë që ka saktësuar se kanë pasur vështirësi për të gjetur dokumentacionin dhe vërtetimet e punësimit për vitet e para.
- **Lidhur me të ardhurat nga qiraja**, subjekti ka sqaruar se banesa e fituar nëpërmjet trashëgimisë është lëshuar me qira, sipas një marrëveshje midis palëve, znj.D.J. e datëlindjes 18.08.1954, banuese në Vlorë dhe pronarit z.I.M., kupola qiramarrëse ka marrë përsipër pagesën në shumën 7.000 lek në muaj, duke derdhur në llogarinë bankare të qiradhënësit, ndërkohë që detyrimet tatimore, si dhe pagesat e tjera drita, ujë etj., do të paguheshin nga qiramarrësi, vërtetuar me deklaratën e lëshuar nga qiramarrësi në prani të shtetasës znj. K.Ç. Gjithashtu, subjekti ka saktësuar se nga vitin 2016 e në vijim, pagesa e tatimit në burim për qiranë e kësaj prone bëhet nga ana e tij.
- **Kontratë shitje** nr. ** rep., nr. **kol., datë 29.09.1999, me shitës znj.C.M., z.I.M. dhe znj. A.M. me blerës z. G.K, për shitjen e apartamentit 2+1, të ndodhur në Rr. **, Tiranë. Vlera 500.000 lek, e likuiduar.
- **Vërtetim** mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare me punëdhënësin Ministria e Brendshme nr. ** prot., datë 20.02.2024, ku vërtetohet se për periudhën 16.06.1998 - 16.03.2001, Ilirjan Mandro ka realizuar të ardhura nga paga neto, në shumën totale rreth 693.500 lek.
- **Vërtetim** mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nr. ** prot., dhe nr. ** prot., datë 21.02.2024, ku vërtetohet se për periudhën 01.02.2008 - 31.12.2013, z.I.M. ka realizuar të ardhura nga paga neto dhe shpërblimet e tjera, në shumën totale rreth 5.970.000 lek.
- **Vërtetim** nga Universiteti Ismail Qemali Vlorë, nr. ** prot., datë 23.02.2024, ku vërtetohet se për periudhën 2008 - 2022, z.I.M. ka realizuar të ardhura nga paga neto, në shumën totale rreth 2.432.302 lek.
- **Kontratë** me Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, me nr. ** prot, datë 12.06.2009, për punësimin si ekspert të z.I.M., për një periudhë 15-ditore. Vërtetim nga Kolegji Universitar Bedër, me nr. ** prot., datë 26.04.2018, ku vërtetohet se z.I.M. ka përfituar të ardhura në shumën totale neto 141.500 lek, për periudhën 2015 - 2016.
- **Dokumentacion në gjuhën angleze:** Marrëveshje bashkëpunimi me UNDP datë 22.11.2010, për ofrimin e shërbimeve nga z.I.M., me pagesë totale 220.000 lek.
- **Dokumentacion në gjuhën angleze:** Amendim marrëveshje bashkëpunimi me UNDP datë 1.06.2011, për ofrimin e shërbimeve nga z.I.M., me pagesë totale 400.000 lek.
- **Të ardhurat** nga trajtimi me pension i nënës së subjektit, për periudhën 1976 - 2000, në vlerën totale të konfirmuar rreth 561.500 lek, nuk janë llogaritur në vlerën totale të ardhurave të subjektit. Gjithashtu, subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur

dokumentacion lidhur me transaksionet e shit-blerjeve të pasurive të paluajtshme, ndër vite.

- **Të ardhurat e subjektit nga qiraja**, për periudhën maj 2013 - mars 2018, konfirmohen në vlerën totale rreth 504.000 lek.
- **Të ardhurat e subjektit nga paga**, dietat dhe shpërblimet, për periudhën janar 1991 prill 2023 konfirmohen në vlerën totale rreth 37.573.439 lek + 17.843 euro e konvertuar rreth 555.000 lek.
- **Të ardhurat e subjektit nga pagat**, dietat, shpërblimet dhe qiraja, për periudhën janar 1991 - prill 2023, janë llogaritur në vlerën totale rreth 40.060.000 lek.

62. Konkluzion:

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjet e institucioneve përkatëse.

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

- ✚ Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

Subjekti ka deklaruar shpenzime për vitin e fundit, për furnizimin me energji elektrike, ujë, telefoni, internet, për periudhën janar - dhjetor 2022.

63. Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

- Shpenzimet për ujë, (janar - dhjetor 2022), **36.560 lek.**
- Shpenzimet për energji elektrike (janar - dhjetor 2022), **80.260 lek.**
- Shpenzimet për Internet/TV/telefon, **44.460 lek.**
- ✓ **Total 161.280 lek.**
- **Shënim:** Shpenzimet e celularit janë të rimbursuara nga institucionet ku punon subjekti dhe bashkëshortja, përkatësisht në shumën 15.060 lek dhe për bashkëshorten rreth 15.000 lek.
- **A.M.** (djali i subjektit), ka deklaruar veçmas:
 - Shpenzimet për ujë, (janar - dhjetor 2022), **21.004 lek.**
 - Shpenzimet për energji elektrike (janar - dhjetor 2022) **49.487 lek.**
 - Shpenzimet për Internet/TV/telefon, **19.200 lek.**
 - ✓ **Total 89.691 lek.**
- **A.M** (vajza e subjektit) me të ardhurat e saj përballon shpenzimet e qirasë, në shumën rreth 700 euro/muaj.

64. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **FSHU me shkresën nr. ** prot., datë 17.08.2023**, konfirmon se me gjeneralitetet I.M. identifikohet si abonent me kontratë furnizimi për energji elektrike, ndërsa me gjeneralitetet I.M., identifikohen 2 (dy) abonentë me kontratë furnizimi për energji elektrike, dhe përkatësisht:
 - **Kontrata** datë 28.02.2009, Konsumatori nr.** ,Kategoria “Familjar Ap”, adresa: ** Vlorë. (ndryshim emri, datë 17.20.2016) Referuar tabelës përmbledhëse, rezulton se: për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, janë paguar detyrimet në shumën totale rreth 4.988 lek.
 - **Kontrata** datë 17.10.2012, Konsumatori nr.** ,Kategoria “Familjar Ap “, adresa:** Vlorë.
 - **Kontrata** datë 15.04.1999, Konsumatori nr.** ,Kategoria “Familjar Përdhes”, adresa: ** Tiranë.
- **FSHU me shkresën nr. **prot., datë 17.08.2023**, konfirmon se me gjeneralitetet znj. A.M. nuk rezultojnë abonentë me kontrata furnizimi, ndërsa me gjeneralitetet znj. A.M. identifikohet 1 (një) abonent me kontratë furnizimi për energji elektrike, dhe përkatësisht:
 - **Kontrata** datë 15.12.2010, Konsumatori nr.** Kategoria “Familjar Përdhes”, adresa: ** Tiranë.
 - **Konfirmon** se me gjeneralitetet A.M. identifikohet 1 (një) abonent me kontratë furnizimi për energji elektrike, dhe përkatësisht: Kontrata datë 18.09.2015, Konsumatori nr.** ,Kategoria “Familjar AP”, adresa rruga ** Tiranë. (ndryshim emri datë 17.01.2017) Referuar tabelës përmbledhëse, rezulton se: për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, janë paguar detyrimet në shumën totale rreth 47.668 lek.
- **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës - Kanalizime Tiranë sh.a me shkresën nr. ** prot., datë 21.08.2023**, konfirmon se në emër të z.I.M. rezulton kontrata nr.** , për objektin e ndodhur në Rr. **, me status “aktiv”, kategoria familjare ,me detyrime të likuiduara deri në qershor 2023.

Referuar tabelës përmbledhëse, rezulton se: për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, janë paguar detyrimet në shumën totale rreth 21.851 lek.

 - **Konfirmohet** se në emër të A.M. rezulton kontrata nr. ** ,për objektin e ndodhur në Rr. **, me status “aktiv ,kategoria “familjare”, me detyrimet të likuiduara deri në qershor 2023. Referuar tabelës përmbledhëse, rezulton se: për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022 , janë paguar detyrimet në shumën totale rreth 10.034 lek.
- **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës - Kanalizime Vlorë sh.a me shkresën nr. ** prot., datë 04.09.2023** konfirmon se në emër të z.I.M. rezulton kontrata nr. **, me adresë: ** lagjja. **, Vlorë. Për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, është faturuar shuma totale rreth 1.584 lek (1.601 lek me kamatëvonesa) si dhe janë paguar detyrimet në shumën totale rreth 1. 726 lek (për faturimet e periudhës: nëntor 2021 - nëntor 2022).
 - **Konfirmon** se në emër të z.I.M. rezulton kontrata nr. **, me adresë: **, lagje. **“. Referuar tabelës përmbledhëse, rezulton se: për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, është faturuar shuma totale rreth 12.976 lek (14.706 lek me kamatëvonesa) si dhe janë

paguar detyrimet në shumën totale rreth 17.702 lek (për faturimet e periudhës: nëntor 2021 - nëntor 2022).

- **13 Shoqëri Rajonale të Ujësjellës - Kanalizime**, me shkresat nr. ** prot., dhe nr. ** prot., datë 14.08.2023 deri në datë 29.05.2024, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- **Vodafone Albania sh.a** me shkresën nr. ** prot., datë 3.11.2023, konfirmon se për vitin 2022: në emër të z.I.M rezulton një numër telefonik, për të cilin janë paguar detyrimet me vlerë totale rreth 15.060 lek, si dhe në emër të znj. A.M., rezulton një numër telefonik, për të cilin janë paguar detyrimet me vlerë totale rreth 13.608 lek. Konfirmon se për vitin 2022 në emër të A.M, rezulton një numër telefonik, për të cilin janë paguar detyrimet me vlerë totale rreth 15.000 lek; si dhe në emër të A.M, rezulton kontratë për internet kabllor, e regjistruar në datë 02.04.2022, me afat 12-muaj dhe me pagesë në shumën 1.100 lek/muaj, aktualisht me status “mbyllur”.
- **One Albania sh.a me shkresën nr. ** prot., datë 26.09.2023**, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- **Albania Satellite Communications sh k** me shkresën nr. ** prot., datë 31.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- **Abissnet sh.a me shkresën nr. V-prot.**, datë 4.09.2023, konfirmon se z.I.M. i datëlindjes. 30.08.1961 ka qenë palë në kontratën e shërbimit të internetit, datë 15.09.2022 dhe faturimi total i pagesave për këtë kontratë, për vitin 2022, ka qenë në shumën 4.800 lek.
- **Digicom sh.a, me shkresën nr. ** prot., datë 11.08.2023**, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

65. Në proces-verbalin e datës 30.04.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke sqaruar se deklarimi i shpenzimeve të djalit A.M. është kryer veçmas duke qenë se është i ndarë nga trangu familjar ndërsa për vajzën A.M shpenzimet për energji elektrike dhe uji janë përfshirë në shpenzimet e deklaruara për qiranë me vlerë rreth 700 euro/muaj, për periudhën kur ka banuar në ambient të marrë me qira në Strasburg të cilin e ka dorëzuar duke banuar aktualisht në Shqipëri.

Lidhur me shpenzimet telefonike dhe shpenzimet për internet, si dhe shpenzimet për jetesë të vajzës A.M. në Holandë, subjekti ka sqaruar se gjatë periudhës së shkollimit janë përballuar si pjesë e financimit të; bursës sipas deklaramit, ndërsa për periudhën në vijim shpenzimet për jetesë të vajzës A.M. në Strasburg janë përballuar nga ndihmat financiare familjare dhe pagat, sipas dokumentacionit të paraqitur.

Subjekti ka sqaruar se:

- **Libreza** për furnizim me energji elektrike, për kontratën nr. ** dhe libreza për furnizim me uji për kontratën nr. ** (zona **), i përkasin apartamentit me sip. 83 m², të ndodhur në Vlorë;
- **Libreza** për furnizim me energji elektrike për kontratën nr. ** dhe libreza për furnizim me uji për kontratën nr. **, i përkasin apartamentit me sip. 71 m², të ndodhur në Vlorë,

- **Libreza** për furnizim me energji elektrike për kontratën nr. ** (në emrin e tij), libreza për furnizim me energji elektrike për kontratën nr. ** (në emër të bashkëshortes), libreza për furnizim me energji elektrike për kontratën nr. ** (në emër të vajzës) dhe libreza për furnizim me uji për kontratën nr. **, i përkasin pasurisë nr. **, vol. **, faqe **, Zk **, e llojit truall me sipërfaqe 543 m², nga e cila ndërtesë me sipërfaqe 140.9 m², me adresë: **, Tiranë duke saktësuar se është hapur një kontratë furnizimi me energji elektrike për çdo kat banimi ndërsa për furnizimin me linjë të godinës është disponuar vetëm një kontratë furnizimi;
- **Libreza** për furnizim me energji elektrike për kontratën nr. ** dhe libreza për furnizim me uji për kontratën nr. **, i përkasin apartamentit me sip. 37.7 m², në Vlorë.
- **Konfirmon**, sipas përgjigjes së FSHU, lidhur me kontratën e konsumatorit A.M. nr. ** dhe sipas përgjigjes së Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a lidhur me kontratën në emër të A.M. nr. ** dhe saktësuar se këto kontrata i përkasin apartamentin me sip. 83.57 m² të ndodhur në Tiranë, deklaruar në bashkëpronësi të bashkëshortes dhe djalit.
- **Konfirmon** shpenzimet telefonike dhe shpenzimet e internetit të djalit A.M., sipas konfirmimit të Vodafone Albania sh.a, si dhe duke konfirmuar sa më sipër lidhur me shpenzimet e rezultuara, sipas përgjigjeve të institucioneve publike dhe private, subjekti ka sqaruar se vlera e shpenzimeve të djalit A.M. është llogaritur dhe rrjedhimisht deklaruar me vlerë të përafërt të gabuar.
- **Lidhur me shpenzimet telefonike** gjatë vitit 2022, për vete dhe bashkëshorten, subjekti ka konfirmuar sipas përgjigjes së Vodafone Albania sh.a, duke saktësuar se shpenzimet e tij telefonike janë kompensuar nga Akademia e Sigurisë, si dhe shpenzimet e bashkëshortes A.M janë kompensuar pjesërisht nga KLP, për periudhën tetor - dhjetor 2022.
- **Lidhur me shpenzimet e internetit** gjatë vitit 2022, për vete dhe bashkëshorten, subjekti ka konfirmuar sipas përgjigjes së Abissnet sha, duke sqaruar se ka deklaruar si shpenzim vlerën vjetore të kontratës, e cila për vitin 2022 ka pasur një vlerë pjesore afërsisht 4.800 lek (1.200 lek/muaj) prej lidhjes së kontratës, në datën 15.09.2022 deri në datën 31.12.2022, duke saktësuar se edhe për periudhën 01.01.2022 - 15.09.2022, ka shpenzuar rreth 1.200 lek/muaj për furnizim me internet për të cilën nuk disponon dokumentacion shtesë.

Me inventarin nr. ** prot., datë 30.04.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Vërtetim nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë** nr.** prot., datë 11.03.2024, ku vërtetohet se për znj. A.M., paguhen nga institucioni shpenzimet telefonike për nr. 068****477, për periudhën tetor - dhjetor 2022 dhe janar - dhjetor 2023.
- **Vërtetim nga Akademia e Sigurisë** nr. ** prot., datë 11.03.2024, ku vërtetohet se I.M. është trajtuar me kompensim për shpenzimet telefonike gjatë vitit 2023, në shumën 7.938 lek.
- **Korrespondenca me postë elektronike** me shërbimin ndaj klientit të Abissnet sh.a, lidhur me pagesat e internetit me vlerë 1.200 lek/muaj për periudhën 21.01.2023 - 22.12.2023.

- **Kopje të librezës për furnizim me energji elektrike** kategoria “familjar”, për kontratën nr.**, në instancën Vlorë, në emër të z. I.M., ku rezulton se për vitin 2022 janë kryer pagesat, në shumën totale rreth 11.400 lek.
- **Kopje të librezës për furnizim me energji elektrike**, kategoria “familjar për kontratën nr. **, në instancën Vlorë, me adresë Rr. **, në emër të I.M., ku rezulton se për vitin 2022 janë kryer pagesat në shumën totale rreth 4.960 lek.
- **Kopje të librezës për furnizim me energji elektrike** kategoria “familjar”, për kontratën nr. **, në instancën **, në emër të I.M., ku rezulton se për vitin 2022 janë kryer pagesat në shumën totale rreth 9.200 lek.
- **Kopje të librezës për furnizim me energji elektrike** kategoria “familjar”, për kontratën nr. **, në instancën **, në emër të A.M., ku rezulton se për vitin 2022 janë kryer pagesat në shumën totale rreth 46.700 lek.
- **Kopje të librezës për furnizim me energji elektrike**, kategoria “familjar”, për kontratën nr. **, në instancën **, në emër të A.M., ku rezulton se për vitin 2022 janë kryer pagesat në shumën totale rreth 4.100 lek.
- **Kopje të librezës për furnizim me energji elektrike**, për kontratën nr. **, në emër të C.M. ku rezulton se për vitin 2022 janë kryer pagesat në shumën totale rreth 16.000 lek.
- **Kopje të librezës për furnizim me ujë**, për kontratën nr. ** (zona **), në instancën Vlorë, me adresë: **, në emër të I.M., ku rezulton se për vitin 2022 janë kryer pagesat në shumën totale rreth 1.600 lek.
- **Kopje të librezës për furnizim me ujë**, për kontratën nr. **, në instancën Vlorë, me adresë: **, në emër të I.M., ku rezulton se për vitin 2022 janë kryer pagesat në shumën totale rreth 13.000 lek.
- **Kopje të librezës për furnizim me uji** për kontratën nr. **, me adresë: Rr. **, në emër të I.M., ku rezulton se për vitin 2022 janë kryer pagesat në shumën totale rreth 21.900 lek.
- **Kopje të librezës për furnizim me ujë** për kontratën nr. **, në instancën Vlorë, në emër të C.M, ku rezulton se për vitin 2022 janë kryer pagesat në shumën totale rreth 8.100 lek.

Me inventarin nr. ** prot., datë 17.05.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Relacion nga Ilirjan Mandro**, ku subjekti ka sqaruar se vajza e tij A.M. ka ndarë një apartament në Strasburg, së bashku me një shokun e saj, për periudhën prill 2021 - gusht 2023, duke kontribuar të dy në qiranë e shtëpisë dhe shpenzimet e tjera lidhur me jetesën. Lidhur me apartamentin e ndodhur në Vlorë, pranë **, ka sqaruar se kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë figurojnë në emër të S.B, duke saktësuar se në këtë apartament nuk banon njeri dhe kontrata me UKT është mbyllur sipas faturës.
- **Dokumentacion në gjuhën franceze:** Kontratë qiraje datë 04.03.2021, me palë qiramarrëse A.M e datëlindje 08.09.1994 dhe HCHK i datëlindjes 03.05.1992, me palë qiradhënëse A.M. për marrjen me qira të një apartamenti në Strasburg, me afat 01.04.2021 - 01.04.2027, me vlerë 1.000 euro/muaj. Komunikimi me postë elektronike, datë 24.07.2023, midis palës qiramarrëse dhe palës qiradhënëse, për dakordësinë e përfundimit të marrëdhënies së qirasë në datë 24.08.2023. Kopje të librezës për furnizim me energji elektrike për kontratën nr. **, në instancën Vlorë, në emër të S.B ku rezulton

se për vitin 2022 janë kryer pagesat mujore me vlerë fikse prej 340 lek, në shumën totale rreth 4.080 lek.

- **Kopje** të librezës për furnizim me linjë për kontratën nr. ** (zona **), me adresë: Vlorë, në emër të S.B. Bashkëlidhur: Kuponi tatimor datë 24.09.2020, për pagesën e shumës 500 lek, me përshkrimin “..Aktiv – Ç ‘aktiv..”.
- **Kopje** të mandat arkëtimeve pranë Vodafone Albania, për pagesat e faturave në emër të I.M. në shumën totale rreth 12.300 lek, për 10 muaj gjatë periudhës janar 2022- dhjetor 2022.
- **Vërtetim** nga Akademia e Sigurisë, me nr.** prot., datë 02.05.2024, ku vërtetohet se I.M. është trajtuar me kompensim për shpenzimet telefonike gjatë viti 2023, në shumën 7.938 lek.
- **Shpenzimet e subjektit** dhe të personave të lidhur për Ujë, drita, telefon dhe internet, gjatë periudhës 01.01.2022 - 31.12.2022, rezultojnë në total rreth 266.000 lek.
- **Vajza e subjektit**, ka kryer shpenzime për jetesë me qira, në Strasburg, me vlerë rreth 700 euro/muaj, për periudhën prill 2021 - prill 2023, me vlerë totale rreth 16.800 euro, e konvertuar rreth 1.865.000 lek. Subjekti ka deklaruar se vajza e tij ka përballuar shpenzimet për jetesë jashtë vendit, me burim financiar fillimisht nga trajtimi me bursë dhe ndihma financiare e prindërve dhe në vijim nga të ardhurat nga puna e saj.
- **Subjekti ka dhënë sqarime** dhe ka paraqitur dokumentacion, lidhur me deklarin dhe përgjigjet e Furnizuesit të Shërbimit Universal, Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës - Kanalizime Tiranë sh.a, Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës - Kanalizime Vlorë sh.a dhe Vodafone Albania sh.a.

66. Konkluzion:

- ✓ Shpenzimet e vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur rezultojnë sipas deklarin dhe dokumentacionin e paraqitur në përputhje me përgjigjet e institucioneve përkatëse.

SHPENZIME PËR UDHËTIME

- ✚ Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara.

Deklarimet e subjektit për periudha 01.01.2020 - 31.01.2022:

Shpenzimet e udhëtimeve private gjatë 3 viteve të fundit të miat (udhëtimi dhe qëndrimi):

- 17 - 21 janar 2020, kanë qenë në shumën rreth 60.000 lek.
- 14 - 21 korrik 2021 në Strasburg tek vajza, në shumën rreth 65.000 lek.

Udhëtimet private të bashkëshortes:

- Viti 2020, kanë qenë udhëtime pune të mbuluara nga institucioni.

- Viti 2021, 14 - 19 qershor, me avion në Strasburg tek vajza;
- Viti 2021, 14 - 21 korrik 2021, me avion në Strasburg tek vajza;
- Viti 2021 10 - 14 tetor 2021, në Strasburg tek vajza.
- Viti 2022, 12 - 20 mars 2022 dhe 26.03.2022 - 05.04.2022, në Strasburg tek vajza;
- Viti 2022: 24 prill 2022 - 01 maj 2022 (Tiranë - Vjenë - Tiranë);
- Viti 2022: 9 - 19 qershor 2022, me avion në Strasburg tek vajza;
- Viti 2022: 12 - 14 qershor 2022, me avion në Strasburg tek vajza;

Shuma e shpenzimeve totale të deklaruara: rreth 570.000 lek.

- Udhëtimet private të vajzës, për periudhën 2020 - 2022, kanë qenë të destinuara për në Tiranë, me shpenzime udhëtimi, bileta, në shumën rreth 2.100 euro. Gjithashtu, vajza me të ardhurat e saj përballon shpenzimet e qirasë, në shumën rreth 700 euro/muaj.
- Artili Mandro (djali i subjektit), ka deklaruar veçmas: Shpenzime për udhëtim në Spanjë, Barcelonë, datë 01.04.2022 - 04.04.2022 (transport dhe qëndrim). Shuma e shpenzimeve: rreth 300 euro.

67. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Kthim përgjigje nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, ku shtetasi Ilirjan Mandro, referuar raportit të hyrje-daljeve ka udhëtuar:**
 - Jet Air Fly në datë 17.01.2020 dhe në hyrje në datë 21.01.2020.
 - Autoveturë në datë 17.02.2020 dhe në hyrje me autoveturë në datë 21.02.2020.
 - Wizz Air në datë 14.07.2021 dhe në hyrje në datë 21.07.2021.
 - Austrian Airlines datë 24.04.2022 dhe në hyrje në datë 01.05.2022.
 - Lufthansa në datë 02.05.2022 dhe në hyrje në datë 07.05.202
 - Wizz Air në datë 20. 7.2022 dhe në hyrje në datë 23.07.202.
 - Wizz Air në datë 22. 1. 2023 dhe në hyrje në datë 24.01.2023.
- **Kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ku shtetasja Arta Mandro, referuar raportit të hyrje-daljeve ka udhëtuar:**
 - Austrian Airlines në datë 14.01.2020 dhe në hyrje në datë 21. 1. 2020.
 - Lufthansa në datë 04.02.2020 dhe në hyrje në datë 07.02.2020.
 - Wizz Air në datë 14.06.2021 dhe në hyrje në datë 19.06.2021.
 - Wizz Air në datë 14.07.2021 dhe në hyrje në datë 21.07.2021.
 - Wizz Air në datë 10.10.2021 dhe në hyrje në datë 14.10.2021.
 - Wizz Air në datë 12.03.2022 dhe në hyrje në datë 20.03.2022.
 - Wizz Air në datë 26.03.2022 dhe ne hyrje në datë 05.04.2022.
 - Austrian Airlines në datë 24.04.2022 dhe në hyrje në datë 01.05.2022.
 - Wizz Air në datë 09.06.2022 dhe në hyrje në datë 12.06.2022.
 - Wizz Air në datë 14.06.2022 dhe në hyrje në datë 19.06.2022.
 - Wizz Air në datë 23.06.2022 dhe në hyrje në datë 3.07.2022.
 - Në dalje me autoveturë në datë 15.11.2022.
- **Kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, shtetasja Anisia Ilirjan Mandro, referuar raportit të hyrje-daljeve ka udhëtuar:**
 - Wizz Air në datë 21.07.2021 dhe në dalje në datë 10.10.2021.

- Wizz Air në datë 27.11.2021 dhe në dalje në datë 10.12.2021.
- Wizz Air në datë 9.03.2022 dhe në dalje në datë 12.03.2022.
- Wizz Air në datë 14.04.2022 dhe në dalje në datë 20.04.2022.
- Wizz Air në datë 1.06.2022 dhe në dalje në datë 7.06.2022.
- Wizz Air në datë 3.07.2022 dhe në dalje në datë 5.07.2022.
- Wizz Air në datë 17.07.2022 dhe në dalje në datë 21.07.2022.
- Në datë 17.12.2022 dhe në dalje në datë 29.12.2022.
- Në datë 3.01.2023 dhe në dalje në datë 14.01.2023.

Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka paraqitur:

- **Praktika e dokumentacionit të udhëtimit** të I.M, Tiranë - Vjenë - Tiranë, për periudhën 24.04.2022 - 30.04.2022, me vlerë 136.92 euro.
- **Urdhër nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit** nr. **, datë 29.04.2022, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit të z.I.M, për periudhën 02.05.2022 - 07.05.2022, në itinerarin Tiranë - Frankfurt - Tiranë.
- **Urdhër nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit** nr. **, datë 18.07.2022, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit të z.I.M., për periudhën 20.07.2022 - 22.07.2022, në itinerarin Tiranë - Romë - Tiranë.
- **Urdhër nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit** nr. **, datë 20.09.2022, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit të z.I.M., për periudhën 20.09.2022 - 23.09.2022, në itinerarin Tiranë - Prishtinë -Tiranë, në rrugë tokësore.
- **I.M., për periudhën 15.11.2022 - 18.11.2022**, në itinerarin Tiranë - Prishtinë - Tiranë, me automjetin me targë **.
- **Urdhër nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit** nr.***, datë 17.01.2023, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit të I.M., për periudhën 22.01.2023 - 24.01.2023, në itinerarin Tiranë - Romë - Tiranë.
- **Praktikën e komunikimeve** shkresore dhe elektronike, lidhur me udhëtimet e planifikuara nga A.M. gjatë vitit 2020, për pjesëmarrje në takime për shkak të funksionit.
- **Praktika e dokumentacionit të udhëtimit** të A.M., Tiranë - Karlsruhe - Tiranë, për periudhën 14.06.2021 - 02.07.2021, me vlerë 130.98 euro.
- **Kopje të biletës së udhëtimit** të A.M., Basel - Tiranë në datë 13.10.2021.
- **Praktika e dokumentacionit të udhëtimit** të A.M., Tiranë - Vjenë - Tiranë, për periudhën 24.04.2022 - 30.04.2022, me vlerë 136.92 euro.
- **Kopje të faturës** me vlerë 84,98 euro, nga Wizz Air për udhëtimin Tiranë - Bazel - Tiranë, në datat 09.06.2022 - 19.06.2022.
- **Praktika e komunikimit** me postë elektronike lidhur me udhëtimin e A.M. për periudhën 23.06.2022 - 03.07.2022, në Strasburg me bileta të paguara nga Këshilli i Evropës.

68. Në proces-verbalin e datës 30.04.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion, duke konfirmuar sipas sqarimeve dhe dokumentacionit të paraqitur dhe duke saktësuar se nuk disponon dokumentacion justifikues shtesë. Subjekti, ka sqaruar se ka deklaruar

shpenzimet e vajzës për qiranë me vlerë 700 euro/muaj, duke saktësuar se këto shpenzime janë kryer me burim financiar nga të ardhurat e saj për periudhën e punësimit dhe përveç dokumentacionit të paraqitur nuk disponon dokumentacion shtesë. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se shpenzimet janë deklaruar me përafërsi duke konfirmuar edhe shpenzimet e tjera për udhëtimet private sipas dokumentacionit dhe sqarimeve të paraqitura, si dhe duke saktësuar se udhëtimet të cilat nuk janë cilësuar si private kanë qenë udhëtime për shkak të funksioneve shtetërore me shpenzime të paguara nga institucionet, për të cilat nuk disponon dokumentacionin e plotë.

Lidhur me shpenzimet e djalit A.M., për udhëtim, subjekti ka sqaruar se janë deklaruar me përafërsi duke mos disponuar dokumentacion shtesë.

Me inventarin nr. ** prot., datë 30.04.2024, subjekti ka dorëzuar

- **Relacion nga I.M.**, ku ka sqaruar se: Udhëtimi në dalje me kompaninë Jet Air Fly në datë 17.01.2020 dhe në hyrje me kompaninë AEGEN në datë 21.01.2020, ka qenë udhëtim privat.
- **Udhëtimi** në dalje me autoveturë në datë 17.02.2020 dhe në hyrje me autoveturë në datë 21.02.2020, ka qenë udhëtim shtetëror sipas ftesës për Konferencë nga departamenti Anti-Diskriminim, në projekti "Horizontal Fitilit 11".
- **Udhëtimi** në dalje me kompaninë Wizz Air në datë 14.07.2021 dhe në hyrje me kompaninë Wizz Air në datë 21.07.2021, ka qenë udhëtim privat sipas dokumentacionit bashkëlidhur për prerjen e biletës me çmim 296 euro.
- **Udhëtimi** në dalje me kompaninë Austrian Airlines në datë 24.04.2022 dhe në hyrje me kompaninë Austrian në datë 01.05.2022, ka qenë udhëtim privat sipas biletës bashkëlidhur.
- **Udhëtimi** në dalje me kompaninë Lufthansa në datë 02.05.2022 dhe në hyrje me kompaninë Lufthansa në datë 07.05.2022, është kryer sipas dokumentacionit bashkëlidhur; Urdhër nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nr. ** datë 29.04.2022, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit të I.M., për periudhën 02.05.2022 - 07.05.2022, itinerari Tiranë - Frankfurt - Tiranë.
- **Udhëtimi** në dalje me kompaninë Wizz Air në datë 20.07.2022 dhe në hyrje me kompaninë Alitalia në datë 23.07.2022, është kryer sipas dokumentacionit bashkëlidhur; Urdhër nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nr. ** datë 18.7.2022, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit të I.M., për periudhën 20.07.2022-22.07.2022, itinerari Tiranë - Romë - Tiranë.
- **Udhëtimi** në dalje me kompaninë Wizz Air në datë 22.01.2023 dhe në hyrje me kompaninë Wizz Air në datë 24.01.2023.
- **Urdhër nga DP Policisë së Shtetit nr.**** datë 17.01.2023, për dërgim me shërbim jashtë shtetit të I.M., për periudhën 22.01. 2023 - 24.01.2023, itinerari Tiranë - Romë - Tiranë.
- **Udhëtimi Tiranë - Vienë - Tiranë**, për periudhën 24.04.2022 - 30.04.2022, ka qenë udhëtim privat me vlerë 136.92 euro.
- **Udhëtimi i bashkëshortes** në dalje me kompaninë Wizz Air në datë 14.06.2021 dhe në hyrje me kompaninë Wizz Air në datë 19.06.2021, është udhëtim shtetëror i kryer sipas

dokumentacionit bashkëlidhur për "Annual Help Network Conference " dhe vërtetimeve të shpenzimeve nga organizatorët.

- **Udhëtimi i bashkëshortes** në dalje me kompaninë Wizz Air ne datë 14.07.2021 dhe në hyrje me kompaninë Wizz Air në datë 21.07.2021, është udhëtim privat sipas dokumentacionit bashkëlidhur për prerjen e biletës me çmim 296 euro.
- **Udhëtimi i bashkëshortes** në dalje me kompaninë Austrian Airlines në datë 24.04.2022 dhe në hyrje me kompaninë Austrian Airlines ne datë 1.05.2022, është udhëtim privat sipas kopjes së biletës në itinerarin Tiranë-Vienë dhe anasjelltas, në shumën 136.92 euro.
- **Udhëtimi i bashkëshortes** në dalje me kompaninë Wizz Air në datë 09.06.2022 dhe ne hyrje me kompaninë Wizz Air ne datë 12.06.2022, është udhëtim privat sipas kopjes së biletës në itinerarin Tiranë-Basel-Mulhouse-Freiburg në shumën 84.98 euro.
- **Vërtetim nga ARLO Travel**, ku vërtetohet se znj.A.M ka shlyer shumën totale l. 032 euro, për bileta udhëtimesh, gjatë periudhës 2021 - 2022; nga të cilat shuma totale prej 736 euro janë pagesa për bileta të A.M. dhe shuma 296 euro është pagesë për biletën e I.M. (korrik 2021).
- **Kopje e biletës së udhëtimit** privat për A.M, itinerari Tiranë - Karlsruhe, datë 12.03.2022, me vlerë 55 euro. Kopje e biletës së udhëtimit privat për A.M, itinerari Karlsruhe - Tiranë, datë 20.03.2022, me vlerë 62 euro.
- **Kopje e biletës së udhëtimit** privat për A.M, itinerari Tiranë - Karlsruhe, datë 26.03.2022, me vlerë 35 euro.
- **Kopje e biletës së udhëtimit privat** për A.M, itinerari Karlsruhe - Tiranë, datë 05.04.2022, me vlerë 70 euro.
- **Kopje të praktikës së udhëtimit të A.M**, periudha 21.07.2021 - 10.10.2021 me vlerë totale rreth 384 euro. Kopje të praktikës së udhëtimit të A.M, periudha 27.11.2021 - 10.12.2021, me vlerë totale rreth 105 euro.
- **Kopje të praktikës së udhëtimit të A.M**, periudha 08.03.2022 - 12.03.2022, me vlerë totale rreth 102 euro.
- **Kopje të praktikës së udhëtimit të A.M**, periudha 13.04.2022 - 20.04.2022, me vlerë totale rreth 198 euro.
- **Kopje të praktikës së udhëtimit të A.M**, periudha 01.06.2022 - 07.06.2022, me vlerë totale rreth 171 euro.
- **Kopje të praktikës së udhëtimit të A.M**, periudha 02.07.2022 - 05.07.2022, me vlerë totale rreth 202 euro.
- **Kopje të praktikës së udhëtimit të A.M**, periudha 16.07.2022-21.07.2022, me vlerë totale rreth 415 euro. Kopje të praktikës së udhëtimit të A.M, periudha 17.12.2022 - 29.12.2022, me vlerë totale rreth 292 euro.
- **Kopje të praktikës së udhëtimit të A.M**, periudha 03.01.2023 - 14.01.2023, me vlerë totale rreth 280 euro.

69. Konkluzion:

- ✓ Konfirmohen deklaramet me dokumentacionin e dorëzuar, sa i përket hyrje - daljeve në R.SH, të subjektit dhe personave të lidhur, gjatë periudhës 01.01.2020 - 31.12.2022.

SHPENZIME PËR ARSIMIN E FËMIJËVE, MADHORË APO TË MITUR

- ✚ Për arsimin e të fëmijëve, madhorë apo të mitur. apo të personave të lidhur, duke deklaruar titullimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohë zgjaten e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të Vlerësimit.

Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë:

Shpenzime për vajzën për periudhën 2010 - vijim: Shuma totale rreth 73.000 euro, - Shkolla e Mesme: 6.000 euro.

Shkolla e Lartë, viti I: 18.000 euro.

Shkolla e Lartë, viti II: 15.500 euro.

Shkolla e Lartë, viti III: 15.000 euro.

Master: 18.000 euro.

Shpenzime për pagesën e regjistrimit të djalit në Shkollën e Magjistraturës, viti 2022. Shuma: 213.200 lek.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Statement** nga Tirana Bank printuar në datën 02.11.2022, për Llogarinë e I.M. ku rezulton debitimi në favor të A.M., i shumës 5.000 euro, në datën 14.06.2022, me përshkrimin “*ndihmë financiare vajzës..*”.
- **Korrespondenca me postë elektronike** e A.M. me University College Utrecht, datë 30.09.2014, ku konfirmohet se është dakordësuar që A.M., si student, të përfitojë bursën me vlerë 3.500 euro, për semestrin e pranverës 2015 dhe bursën me vlerë 7.000 euro, për vitin akademik pasardhës.
- **Korrespondenca me postë elektronike** e A.M, datë 05.07.2016, ku konfirmohet se sipas dokumentacionit bashkëlidhur A.M., si student master në Utrecht University, përfiton bursën SYLFF me vlerë 15.000 euro.

70. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Tirana Bank me shkresën nr. ** prot., datë 14.08.2023** konfirmon se në llogari të A.M. rezulton kreditimi cash i shumës 8.928 euro, në datën 25.07.2013 dhe debitimi me transfertë i shumës 8.900 euro, në datën 25.07.2013, me përshkrimin “*Universiteti Utrecht/Centrale..*”.
- **Kreditimi cash** i shumës 3.900 euro, në datën 22.08.2013 dhe debitimi me transfertë i shumës 3.880 euro, në datën 26.08.2013, me përshkrimin University College Utrecht.

- **Kreditimi cash i shumës** 8.130 euro, në datën 27.08.2014 dhe debitimi me transfertë i shumës 8.106 euro, në datën 27.08.2014, me përshkrimin Universiteti College Utrecht..
- **Kreditimi cash** nga I.M. i shumës 9.150 euro dhe debitimi me transfertë i shumës 9.150 euro, në datë 10.09.2014, me përshkrim 'UË/Central Student Administration kreditimi cash i shumës 18.000 euro dhe debitimi me transfertë në favor të A.M. i shumës 18.000 euro në datë 20.07.2017.
- **Tirana Bank me shkresën nr. ** prot.**, datë 14.08.2023 konfirmon se në llogari të I.M., rezulton debitimi në favor të A.M., i shumës 615.000 lek në datën 03.11.2021, me përshkrimin “..shpenzime jetese..“ dhe debitimi me transfertë i shumës totale 213.200 lek, në datë 20.06.2022, me përshkrimin ‘..tarifë shkollimi, A.M.
- **Konfirmon** se në llogari të I.M., rezulton debitimi në favor të A.M. i shumës 5.000 euro, në datën 14.06.2022, me përshkrimin “..ndihmë financiare vajzës..”.

71. Në proces-verbalin e datës 30.04.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke sqaruar se shpenzimet e shkollimit të vajzës janë përballuar sipas transaksioneve bankare të konfirmuara dhe diferenca sipas të ardhurave nga bursa.

Me inventarin nr. **prot., datë 30.04.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Relacion nga I.M,** ku ka sqaruar se të gjitha shpenzimet dhe pagesat për arsimimin e fëmijëve janë bërë nëpërmjet sistemit bankar me të ardhura me burim kursime familjare ndër vite dhe bursave të përfituara prej tyre në universitetet përkatëse.
- **Statement të llogarisë rrjedhëse** në emër të A.M., në Rabo Bank, ku rezulton:
 - **Kreditimi** i të ardhurave nga Këshilli i Evropës, për periudhën 25.01.2021 - 31.12.2023; kreditimi me transfertë nga I.M i shumës 4.985 euro, në datën 05.11.2021, me përshkrimin “..shpenzime jetese..“;
 - **Kreditimi** me transfertë nga S.Xh. i shumës 4.360 euro, në datën 28.04.2022, me përshkrimin “..transfertë personale..”.
 - **Kreditimi** me transfertë nga I.M i shumës 4.990 euro, në datën 15.6.2022, me përshkrimin “..suport financiar vajzës..”.

72. Në proces-verbalin e datës 17.05.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke sqaruar se vajza ka ndjekur shkollën, sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe në vijim, prej përfundimit të shkollimit deri në v.2019, ka banuar në pjesërisht në Shqipëri dhe pjesërisht në Holandë, për të cilat është e pamundur të specifikohet koha e saktë e qëndrimit (duke përballuar shpenzimet e jetesës me burim financiar kursimet nga të ardhurat familjare).

Me inventarin nr. ** prot., datë 17.05.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Relacion nga I.M,** ku ka sqaruar se “...pagesa e shkollës së mesme, për periudhën 2010 - 2013, është kryer sipas dokumentacionit të paraqitur, ndërsa shpenzimet e jetesës gjatë

shkollimit në Utrecht, për periudhën 2013 - 2017, janë përballuar pjesërisht nga bursa dhe pjesërisht nga ndihmat familjare... ”. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se për periudhën 2019-2023, vajza e tij A.M ka punuar pranë Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës, duke saktësuar se prej muajit tetor 2023 vajza ka marrë një vit sabbatik dhe është angazhuar në konsulence pranë UNDP-së, duke përfituar të ardhura në llogari pranë Raiffeisen Bank.

- **Kthim përgjigje nga Turgut Ozal**, me nr. ** prot., datë 23.04.2018, ku vërtetohet se për nxënësen A.M. janë kryer pagesat e shkollimit me vlerë totale 6.000 euro, për periudhën 2010 - 2013.
- **Diplomë e maturës shtetërore nga shkolla Turgut Ozal**, datë 09.07.2013, për A.M.
- **Diplomë Bachelor nga Universiteti Utrecht**, datë 31.07.2016, për A.M.
- **Diplomë master nga Universiteti Utrecht**, datë 31.07.2017, për A.M.
- **Dokumentacion në gjuhën angleze**: Lidhur me komunikimin elektronik me Rabo bank, ku kërkesës për vendosjen në dispozicion të dokumentacionit bankar për periudhën para muajit korrik 2017, është kthyer përgjigja se dokumentacionet bankare administrohen për një periudhë maksimale 7 vjeçare dhe për periudhat e mëhershme ky dokumentacion asgjësohet.
- **Dokumentacion në gjuhën angleze**: Marrëveshje për trajnimin e A.M pranë Komisionit Evropian, për periudhën 01.10.2019-29.02.2020, me pagesë 1.196 euro/muaj.
- **Dokumentacion në gjuhën angleze**: Kontrata e punësimit të A.M. si oficerë projektsh pranë Këshillit të Evropës, datë 04.12.2020, me pagë neto 3.492 euro/muaj, për periudhën 01.01.2021 - 31.08.2022. Bashkëlidhur: Aneks kontratë datë 23.05.2022, për zgjatjen e afatit të kontratës së punësimit deri në datën 31.12.2022.
- **Dokumentacion në gjuhën angleze**: Kontrata e punësimit të A.M. pranë Këshillit të Evropës, datë 14.12.2022, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024.
- **Dokumentacion në gjuhën angleze**: Konfirmimi nga Këshilli i Evropës datë 19.07.2023, për marrjen nga A.M. të një periudhe pushimi pa pagesë, prej datës 01.10.2023 deri në datën 30.09.2024.
- **Statement i llogarisë bankare të A.M.** pranë Raiffeisen Bank, hapur në datën 20.06.2023, ku rezulton kreditimi i të ardhurave nga UNIDID, prej datës 22.11.2023.
- **Dokumentacion në gjuhën angleze**: Kontratë konsulence midis United Nations dhe A.M, nr. **, datë 29.09.2023, me afat 1.10.2023 - 30.12.2023, dhe pagesë totale 18.000 USD Bashkëlidhur: Mandatpagesat e shumës totale prej 18.000 USD, në favor të A.M, për periudhën 16.11.2023 - 11.01.2024.

73. Konkluzion:

- ✓ Shpenzimet e kryera për arsimimin e fëmijëve, gjatë periudhës deri në datën 27.04.2023, rezultojnë në shumën totale 79.536 euro + 213.000 lek, e konvertuar rreth 9.044000 lek, nga të cilat: shuma 25.500 euro, e konvertuar rreth 2.831.000 lek, është financim nga bursa e studimit; dhe diferenca prej 54.036 euro + 213.000 lek e konvertuar rreth 6.213.000 lek është investim me burim financiar nga të ardhurat familjare të subjektit.

- ✓ Shpenzimet e kryera si ndihmë financiare për vajzën, gjatë periudhës deri në datën 27.04.2023, rezultojnë në shumën totale rreth 615.000 lek + 5.000 euro, e konvertuar rreth 1.317.000 lek.

DEKLARIMI 1 BASHKËSHORTES - ARTA MANDRO

DEKLARIMI 1 PASURIVE

- ✚ Apartament me sipërfaqe 54.2 m². Trashëgimi nga nëna S.B. Apartamenti është blerë në shumën 1.800.000 lek dhe është rivlerësuar sipas raportit të rivlerësimit datë 29.10.2013, në vlerën 5.000.000 lek, regjistruar në datë 20.12.2013. ZVRPP Vlorë. Data e regjistrimit: 15.02.2006.

Burimi i krijimit: Trashëgimi nga nëna. Vlera: 0 lek. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës.

- **Certifikatë për vërtetim pronësie**, lëshuar në datë 15.02.2006, për pasurinë nr. ** vol. **, faqe **, zk **, e Llojit apartament me sipërfaqe 54 m², me adresë: **, P. ** Vlorë; regjistruar në pronësi të A.M. ➤ Kartela e pasurisë nr. **, vol. ** faqe **, zk **, e Llojit apartament me sipërfaqe 54 m², me adresë: **, L.. **, P. ** Shkalla **, Vlorë, regjistruar në pronësi të A.M, në datën 14.02.2006.
- **Vendim nr. 1453, datë 16.09.2005**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësit S.B. dhe S.B, me trashëgimtarë A.M dhe D.B.

74. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **ASHK (online), konfirmon pasurinë** nr. **, vol. **, faqe **, zk **, me adresë: **, Vlorë, regjistruar në pronësi të **, me status “aktive”, me përshkrimin “...çmim rivlerësimi 5.000.000 lek...”.

75. Në proces-verbalin e datës 30.04.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke deklaruar se apartamenti i trashëguar, është i pa investuar dhe i pa mobiluar duke mos u përdorur për qëllime fitimi.

Me inventarin nr. ** prot., datë 30.04.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Kontratë shit-blerje** datë 12.09.2001, me blerës S.B, me shitës H.A, F.A dhe A. A., për blerjen e apartamentit 1+1 të ndodhur në Lagjen. ** P. **, zk.**Vlorë. Vlera 1.800.000 lek, e likuiduar.
- **Raport vlerësimi datë 28.10.2013**, për pasurinë nr. **, e llojit apartament me sipërfaqe 54,2 m², me adresë: **, P **, Vlorë. Vlera e tregut: 5.000.000 lek.
- **Formular aplikimi** për rivlerësim ku rezulton tatimi për t'u paguar në vlerën 36.552 lek.
- **Mandatpagesa**, për shumën 36.552 lek.

- **Certifikatë për vërtetim pronësie** lëshuar në datë 20.12.2013, për pasurinë nr. ***, vol. **, faqe **, zk **, e llojit apartament me sipërfaqe 54,2 m², e ndodhur në Vlorë; regjistruar në pronësi të A.M.
- **Kartela e pasurisë** nr. ** vol. **, faqe **, zk **, e llojit apartament me sipërfaqe 54,2 m², me adresë: Rr. **, P **, Shkalla**, Vlorë; regjistruar në pronësi të A.M, me çmim rivlerësimi 5.000.000 lek.
- **Fotografi të ambienteve të jashtme dhe të brendshme të pasurisë së paluajtshme** (e pa investuar dhe e pa-mobiluar).

76. Në proces-verbalin e datës 17.05.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim, duke saktësuar se nuk disponon dokumentacion shtesë, lidhur me dakordësinë e bashkëshortes së tij A.M dhe vëllait të saj D.B, për ndarjen e pasurisë së trashëguar.

Me inventarin nr. ** prot., datë 17.05.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Relacion nga I.M.,** ku ka sqaruar se: lidhur me pasuritë e trashëguara nga prindërit e tyre, A.M. dhe vëllai i saj D.B, si trashëgimtarë kanë vendosur që në ndarjen e pasurisë të kompensojnë njëri-tjetrin, dhe konkretisht, D.B. ka përfituar pjesën e trashëgimisë nga A.M. në apartamentin e ndodhur në sheshin **, rruga **, Vlorë, ndërsa A.M. ka përfituar pjesën e trashëgimisë nga D.B. në apartamentin e ndodhur tek ** Vlorë, duke rregulluar në këtë mënyrë ndarjen në natyrë të pasurive mes trashëgimtarëve.
- **Certifikatë për vërtetim pronësie** lëshuar në datë 15.02.2006, për pasurinë nr. **, vol. **, faqe **, zk **, e llojit apartament me sipërfaqe 71 m², me adresë: Rr. **, P. ** Vlorë; regjistruar në pronësi të D.B.

77. Konkluzion:

- ✓ Apartamenti me sipërfaqe 54,2 m² në Vlorë, me nr. pasurie **, vol. **, faqe **, zk **, i blerë nga nëna e bashkëshortes, me vlerë 1.800.000 lek, në vitin 2001, është përfituar nga bashkëshortja e subjektit, si trashëgimtare ligjore në vitin 2005.
- ✓ Bashkëshortja e subjektit dhe vëllai i saj janë dakordësuar të ndajnë me vullnetin e tyre, pjesët takuese të përfituara me trashëgimi ligjore nga prindërit. Është dokumentuar pronësinë e bashkëshortes së tij, në apartamentin e deklaruar në sheshin ** dhe pronësinë e vëllait të saj, në apartamentin në Rr. **.
- ✓ Janë kryer shpenzime për pagesë të detyrimeve tatimore, lidhur me rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme, në vlerën totale rreth 36.500 lek.

- ✚ Apartament me sipërfaqe 83.57 m², në bashkë pronësi me djalin sipas kontratës së shitblerjes datë 16.12.2016, në ZVRPP Tiranë. Data e regjistrimit: 28.12.2016.

Burimi i krijimit: Kursime familjare nga të ardhurat ndër vite. Vlera: 75.000 euro. Zotëron 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Certifikatë për vërtetim pronësie** nr.** , lëshuar në datën 28.12.2016, për pasurinë nr. **, vol.** , faqe **, Zk **, e llojit apartament me sipërfaqe 83.57 1712, me adresë: Tiranë, **, AP. **; regjistruar në bashkë pronësi të A.M dhe A.M.
- **Kartela e pasurisë** nr. ** vol. **, faqe **, Zk **, e llojit apartament me sipërfaqe 83.57 m², me adresë: Tiranë, Shkalla.** , K **, AP. **; regjistruar në bashkë pronësi të A.S.M dhe A.I.M, në datë 28.12.2016, “..për shumën e paguar 75.000., kontratë shitje nr. ** datë 16.12.2016“.
- **Kontratë shitje me rezervë** nr. ** rep., nr. ** kol., datë 16.12.2016, me blerës A.M dhe A.M. shitës shoqëria ** shpk, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 83.57 m² (plus sipërfaqe përbashkët 8.51 m²), me nr. pasurie ** vol. **, faqe **, Zk **, me adresë: **, Hyrja **, Kati **, Apartamenti **, Tiranë. Vlera 75.000 euro (e konvertuar në shumën 10.130.250 lek, me kurs këmbimi 135.07 lek), e cila likuidohet në shumën 70.000 euro në datën e lidhjes së kontratës në llogari të noteres dhe në shumën 5.000 euro, brenda tre muajsh nga lidhja e kontratës.
- **Mandat transfertë në ISP Bank**, datë 16.12.2016, për transferimin e shumës 70.000 euro, nga llogaria e A.M, në llogari të M.D. PF, me përshkrimin “...kalim sipas kontratës nr. ** rep., nr. ** kol., datë 16.12.2016...”
- **Vërtetim nga ISP Bank**, datë 28.07.2022, ku vërtetohet se në datë 24.03.2017 është kryer një pagesë e urdhëruar nga znj. A.M., në favor të S.T ”...për blerje apartamenti, sipas kontratës nr. ** rep., nr. ** kol., datë 16.12.2016...”. Pavarësisht se në statement është vendosur gabimisht përshkrimi se transfertë është urdhëruar nga S.T, në favor të llogarisë së tij. Ekstrakt historik nga QKB, për subjektin tregtar ** shpk, me administrator shtetasin S.T.
- **Mandat depozitimi cash i shumës 70.000 euro**, në datën 16.12.2016, në llogarinë bankare nga A.M, me përshkrimin “..të ardhura nga kursimet, tërhequr nga Tirana Bank...”.
- **Mandat transfertë në ISP Bank, datë 16.12.2016**, për transferimin e shumës 70.000 euro, nga llogaria e A.M në llogari të M.D PF, me përshkrimin “kalim sipas kontratës nr. **rep., nr. ** kol., datë 16.12.2016”.
- **Mandat tërheqje cash nga Tirana Bank**, për shumën 58.000 euro, nga A.M në datën 16.12.2016.
- Mandat depozitimi cash i shumës 5.000 euro, në datën 24.03.2017, në llogarinë bankare nga A.M, me përshkrimin “..kursime nga veprimtaria akademike dhe projekte”.
- **Mandat transfertë në ISP Bank**, datë 24.03.2017, për transferimin e shumës 5.000 euro, nga llogaria në llogari, me përshkrimin “..S.T, kalim për blerje apartamenti, kësti i fundit sipas kontratës nr. ** rep., nr. ** kol., datë 16.12.2016..”.
- **Statement nga ISP Bank**, printuar në datën 28.07.2022, për llogarinë e A.M, ku rezulton: kreditimi cash i shumës 70.000 euro, në datën 16.12.2016, me përshkrimin “..të ardhura nga kursimet, tërhequr nga Tirana Bank..”; debitimi me transfertë i shumës 70.000 euro, në datën 16.12.2016, me përshkrimin “..kalim sipas kontratës nr. ** rep., nr. ** kol., datë 16.12.2016”.; kreditimi cash i shumës 5.000 euro, në datën 24.03.2017, me përshkrimin “..kursime nga veprimtaria akademike dhe projekte..”; si dhe debitimi

me transfertë i shumës 5.000 euro, në datën 24.03.2017, me përshkrimin “..kalim për blerje apartamenti, kësti i fundit sipas kontratës nr. **rep., nr. ** kol., datë 16.12.2016..”

- **Tirana Bank me shkresën nr. ** prot., datë 14.08.2023**, konfirmon se në llogari të A.M., rezulton kreditimi i shlyerjes së depozitës me vlerë 57.881 euro, në datë 07.10.2016 dhe debitimi cash i shumës 58.000 euro, në datën 16.12.2016, me përshkrimin “...tërheqje fondesh për blerje apartamenti...”

78. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Jug**, me shkresën nr. ** prot., datë 27.09.2023 konfirmon se në emër të A.M dhe A.M rezulton e regjistruar pasuria nr. **, vol. **, faqe **, Zk **, përfituar me kontratë shitje.
- **Kartela e pasurisë nr. **, vol. **, faqe **, Zk **, e llojit apartament me sipërfaqe 83.57 m², me adresë: Tiranë, Shkalla.**, K. **, AP. **; regjistruar në bashkë pronësi të A.S.M dhe A.I.M në datë 28.12.2016, ' .për shumën e paguar 75.000., kontratë shitje nr. ** datë 16.12.2016..**
- **Kontratë shitje me rezervë nr. ** rep., nr. **kol., datë 16.12.2016**, me blerës A.M. dhe A.M, shitës shoqëria ** shpk, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 83.57 m² (plus sipërfaqe e përbashkët 8.51 m²), me nr. pasurie **, vol. **, faqe **, Zk **, me adresë: **, Hyrja **, Kati **, Apartamenti **, Tiranë. Vlera 75.000 euro (e konvertuar në shumën 10.130.250 lek, me kurs këmbimi 135.07), e Cila likuidohet në shumën 70.000 euro në datën e lidhjes së kontratës në Llogari të noteres dhe në shumën 5.000 euro brenda tre muajsh nga lidhja e kontratës.
- **Mandat transfertë në ISP Bank datë 16.12.2016**, për transferimin e shumës 70.000 euro nga llogaria e A.M në Llogari të M.D, PF, me përshkrimin “...kalim sipas kontratës nr. ** rep., nr. ** kol., datë 16.12.2016...”.
- **ASHK (online), konfirmon pasurinë nr. **, vol. **, faqe **, Zk **, e ndodhur në Tiranë, regjistruar në bashkë pronësi të A.I.M dhe A.S.M, me status “regjistrim i përkohshëm”**

79. Në proces-verbalin e datës 30.04.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, dhe sqaruar se si burim financiar për blerjen dhe investimet në pasuritë e paluajtshme kanë shërbyer kursimet nga të ardhurat familjare. Gjithashtu, subjekti ka konfirmuar se likuidimi i vlerës së apartamentit është lyer sipas transaksioneve bankare, duke sqaruar se në këtë apartament banon djali A.M dhe mobilimi është kryer nga djali (pjesë - pjesë) duke mos disponuar dokumentacion vërtetues lidhur me vlerën e shpenzuar.

80. Konkluzion:

- ✓ Apartamenti me sipërfaqe 83.57 m², në Tiranë, me nr. pasurie **, vol. **, faqe **, Zk ** është blerë nga bashkëshortja dhe djali i subjektit, me vlerë 75.000 euro, të likuiduar në shumën 70.000 euro, në dhjetor 2016 dhe në shumën 5.000 euro në mars 2017, me burim financiar kursimet nga të ardhurat familjare, dhe u mobiluar pjesë-pjesë, me vlerë të papërcaktuar dhe duke u përdorur nga djali i subjektit për banim.

✚ Truall 543 m², nga e cila 140.9 m² ndërtesë me adresë: Rr. ** Tiranë, në bashkë pronësi me bashkëshortin. Data e regjistrimit 20.07.2016.

Burimi i krijimit: Kursime familjare nga të ardhurat e krijuara ndër vite. Vlera: 7.991.400 lek. Zotëron 50%. (Trajtuar më sipër).

✚ Apartament me sipërfaqe 83 m² në Vlorë, në bashkë pronësi me bashkëshortin, sipas kontratës së shitjes datë 29.12.2012. Regjistruar në ZVRPP Vlorë: vërtetim pronësie datë 24.01.2013, certifikate pronësie datë 13.07.2015.

Burimi i krijimit: Kursime familjare nga të ardhurat e krijuara ndër vite. Vlera: 72.000 euro. Zotëron 50%. (Trajtuar më sipër).

✚ Apartament banimi me sipërfaqe 37.7 m², në Vlorë, regjistruar në ZVRPP në datë 25.01.2022, në bashkë pronësi me b/shortin. Përfitur nga Enti Kombëtar i Banesave në datë 20.08.1993 nga nëna e b/shortit, paguar shuma 2.428 lek dhe rivlerësuar (është paguar aplikimi në vlerën 47.923 lek).

Burimi i krijimit: Trashëgimi nga nëna e bashkëshortit. Vlera: 0 lek. Zotëron 33.33 %. (Trajtuar në sipër).

✚ Apartament banimi me sipërfaqe 71 m², me adresë: **, Vlorë, në bashkë pronësi me bashkëshortin sipas kontratës datë 30.01.2016. Regjistruar në ZVRPP Vlorë në datën 10.02.2016.

Burim krijimi: Kursime familjare nga të ardhurat nga puna. Vlera: 45.840 euro. Zotëron 50%. (Trajtuar më sipër).

✚ Garazh me sipërfaqe 18 m² në Vlorë, në bashkë pronësi me /shortin sipas kontratës së shitjes datë 29.12.2012. Regjistruar në ZVRPP Vlorë me vërtetim pronësie datë 24.01.2013 dhe certifikate pronësie datë 13.07.2015.

Burimi i krijimit: Kursime familjare nga të ardhurat nga puna. Vlera: 750.000 lek. Zotëron 50%. (Trajtuar më sipër).

✚ Automjet Mercedes Benz E 220 CDI, vit prodhimi 2006, blerë në datën 05.02.2015 në bashkë pronësi me b/shortin sipas kontratës noteriale. Data e regjistrimit: 05.02.2015.

Burimi i krijimit: Kursime familjare nga të ardhurat nga puna. Vlera: 7.000 euro. Zotëron 50%. (Trajtuar më sipër).

✚ Llogari (individuale) page në Raiffeisen Bank, me balancë në datën 19.04.2023.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga dhe honorare. Vlera: 3.962.863 lek. Zotëron 100%.

81. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 10.08.2023**, konfirmon se në emër të A.M rezulton Llogari rrjedhëse me balancë 3.962.863 lek, në datën 27.04.2023. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi i të ardhurave nga pagat, dietat, shpërblimet dhe honorarët, për periudhën 04.04.2005 - 04.04.2023.

82. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Raiffeisen Bank, është krijuar gjatë periudhës 2005 - 2023.

✚ Llogari (individuale) rrjedhëse në Raiffeisen Bank, me balancë në datën 19.04.2023.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga punësimi në Shkollën e Magjistraturës dhe konsulence. Vlera: 39.350 euro. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Statement nga Raiffeisen Bank printuar në datën 19.04.2023, për llogari në A.M me balancë 32.356 euro në datën 01.01.2023, ku rezulton kreditimi i të ardhurave nga honorarë dhe pagesa për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

83. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Raiffeisen Bank, me shkresën nr. prot., datë 10.08.2023** konfirmon se në emër të A.M. rezulton llogari rrjedhëse me balancë 39.350 euro, në datën 27.04.2023. Referuar në statement bankar rezulton kreditimi i të ardhurave, për periudhën 23.05.2016-07.03.2023.

84. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Raiffeisen Bank, është krijuar gjatë periudhës 2016 - 2023.

✚ Llogari (individuale) rrjedhëse në Credins Bank, me balancë në datë 20.04.2023.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga dhe dietat. Vlera: 0 euro. Zotëron 100%.

Me inventarin nr. ** prot., datë 30.04.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Relacion nga I.M,** ku ka saktësuar se llogarinë Credins Bank është mbyllur.

85. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Credins Bank me shkresën nr. ** prot., datë 02.10.2023** konfirmon se në emër të A.M rezulton llogari rrjedhëse në Euro, e mbyllur në datën 01.06.2012 si dhe llogari rrjedhëse në euro, e mbyllur në datën 13.10.2022.

86. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Credins Bank, është krijuar gjatë periudhës 2011 - 2022 dhe aktualisht rezulton me status “mbyllur”.

✚ Llogari (individuale) rrjedhëse në Intesa Sanpaolo Bank, me balancë në datën 20.04.2023.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga konsulence, ekspertiza, trajnime. Vlera: 19.668.304 lek. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Statement nga Intesa Sanpaolo Bank**, printuar në datën 20.04.2023, për llogari në e A.M. me balancë 18.860.281 lek, në datën 31.12.2022, ku rezulton kreditimi i të ardhurave si eksperte, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

87. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Intesa Sanpaolo Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 21.09.2023**, konfirmon se në emër të A.M rezulton llogari rrjedhëse me balancë 19.668.304 lek, në datën 27.04.2023. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi i llogarisë për periudhën 14.12.2006 - 31.03.2023, nga të cilat: kreditim i të ardhurave nga pagat dhe interesat për periudhën 04.12.2009 - 31.03.2023.

88. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Intesa Sanpaolo Bank, është krijuar gjatë periudhës 2006 – 2023.

 Llogari (individuale) rrjedhëse në Intesa Sanpaolo Bank, me balancë në datën 20.04.2023.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga konsulence, ekspertiza, trajnime. Vlera: 14.008 USD. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Statement nga Intesa Sanpaolo Bank**, printuar në datën 20.04.2023, për llogari në e A.M me balancë 14.005 USD, në datën 31.12.2022.

89. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Intesa Sanpaolo Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 21.09.2023**, konfirmon se në emër të A.M rezulton llogari depozitë në Usd, e mbyllur deri në vitin 2005, si dhe llogari rrjedhëse me balancë 14.008 USD, në datën 27.04.2023. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi i të ardhurave për periudhën 26.04.2010-31.03.2023.

90. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Intesa Sanpaolo Bank, është krijuar gjatë periudhës 2010 - 2023.

 Llogari (individuale) rrjedhëse në Intesa Sanpaolo Bank, me balancë në datën 20.04.2023.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga konsulencia, ekspertiza, trajnime. Vlera: 62.496 euro. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Statement nga Intesa Sanpaolo Bank**, printuar në datën 20.04.2023, për llogarinë e A.M. me balancë 59.827 euro, në datën 31.12.2022, ku rezulton kreditimi i të ardhurave nga K. E. dhe nga International Labour Office, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

91. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Intesa Sanpaolo Bank, me shkresën nr. **, datë 21.09.2023**, konfirmon se në emër të A.M., rezulton llogari rrjedhëse me balancë 62.495 euro, në datën 27.04.2023. Referuar në statement bankar rezulton kreditimi i të ardhurave për periudhën 04.05.2010 - 28.02.2023.

92. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Intesa Sanpaolo Bank, është krijuar gjatë periudhës 2010 - 2023.

✚ Llogari (individuale) rrjedhëse në Intesa Sanpaolo Bank, me balancë në datën 20.04.2023.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga konsulenca, ekspertiza, trajnime. Vlera: 1.8 GBP. Zotëron 100%

Bashkëlidhur deklaratës:

- Statement nga Intesa Sanpaolo Bank, printuar në datën 20.04.2023, për llogarinë e A.M. me balancë 1.8 GBP, në datën 31.12.2022.

93. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Intesa Sanpaolo Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 21.09.2023**, konfirmon se në emër të A.M, rezulton llogari rrjedhëse me balancë 1.8 GBP, në datën 27.04.2023.

94. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Intesa Sanpaolo Bank, është krijuar gjatë periudhës 2014 - 2017.

✚ Fondi i Investimit në Raiffeisen Bank, lançuar në datën 11.02.2022.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga punësimi në Shkollën e Magjistraturës, konsulenca. Vlera: 5.000.000 lek. Zotëron 100%.

95. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Raiffeisen Invest, me shkresën nr. ** prot., datë 11.08.2023**, konfirmon se A.M. ka një marrëdhënie juridike duke investuar në Fondin RFZ Vizion, prej datës 11.02.2022. Referuar pasqyrës së llogarisë, rezulton blerja e 4.428, 0763 kuotave, në shumën e prej 5.000.000 lek, në datën 11.02.2022 (me vlerë 5.029.493 lek, në datën 27.04.2023).

96. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Raiffeisen Invest, është krijuar gjatë periudhës 2022 – 2023.

🚩 Bono Thesari në Tirana Bank, investuar në datën 22.09.2023 me nr. ** ..

Burimi i krijimit: Kursime nga paga ime dhe të ardhura nga veprimtaria profesionale, si eksperte në fushën e drejtësisë. Vlera: 5.000.000 lek. Zotëron 100%.

97. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Tirana Bank me shkresën nr. ** datë 14.08.2023**, konfirmon se në emër të A.M., rezultojnë dy llogari depozitë me balancë 0 lek dhe një llogari page me balancë 676.851 lek, në datën 27.04.2023.
- **Referuar në statement** bankar rezulton:
 - kreditimi i të ardhurave nga pagat dhe interesave të depozitave, për periudhën 04.09.2008 - 26.08.2021;
 - **kreditimi i depozitës** së maturuar në shumën 3.152.369 lek, në datën 22.07.2022;
 - **kreditimi i depozitës** së maturuar në shumën 2.535.712 lek, në datën 26.08.2022,
 - **debitimi** i shumës 5.010.000 lek, në datën 22.09.2022, me përshkrimin “..për pjesëmarrje B. Th.”.

98. Në proces-verbalin e datës 30.04.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë dhe ka sqaruar se; duke deklaruar të ardhurat nga pagat dhe veprimet, në llogarinë në Tirana Bank dhe duke paraqitur statement bankar, është menduar i ezauruar detyrimi për deklarim të balancës së llogarisë, si dhe duke konfirmuar sipas përgjigjes së Tirana Bank, ka saktësuar se duke qenë likuiditet bankar me burim financiar të ligjshëm dhe lehtësisht i verifikueshme, nuk ka pasur asnjë arsye apo qëllim mos deklarimi.

Me inventarin **prot., datë 30.04.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Vërtetim blerje Bono Thesari, nga Tirana Bank**, në shumën 5.000.000 lek, në emër të klientit A.M, me datë emetimi 22.09.2022 dhe datë maturimi 21.09.2023.

99. Konkluzion:

- ✓ Llogaria Bono Thesari, është krijuar gjatë periudhës 2022 - 2023; ndërsa llogaria e pagës me balancë 676.851 lek, në datën 27.04.2023, është krijuar sipas kreditimeve gjatë periudhës 2008 - 2021.

🚩 Llogari (individuale) Credit Card në Raiffeisen Bank.

Llogari e lidhur me llogarinë e pagës. Vlera: 2.000 euro. Zotëron 100%.

100. Hetimi i trupës së vlerësimit

- **Raiffeisen Bank, me shkresën nr. **prot., datë 10.08.2023** konfirmon se në emër të A.M rezulton Llogari për tërheqje Master Card, me limit 2.000 euro dhe balancë 0 euro, në datën 27.04.2023.

101. Konkluzion:

- ✓ Llogaria në Raiffeisen Bank, është krijuar gjatë periudhës 2016 - 2023.

🚦 Gjendje Cash, me balancë 600.000 lek në datën 26.04.2023.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga puna. Vlera: 600.000 lek. Zotëron 100%.

102. **Konkluzion:**

✓ Të ardhurat e realizuara justifikojnë gjendjen cash të deklaruar.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- **Të ardhura** nga paga në Fakultetin e Drejtësisë, për periudhën shtator 1986 - 1992. Shuma: 62.000 lek (me sa mbaj mend).
- **Të ardhura** nga paga në Fakultetin e Drejtësisë, për periudhën shtator 1992 - tetor 1998. Shuma: 941.256 lek.
- **Të ardhura** nga paga në Ministrinë e Drejtësisë, me detyrë Zv/Ministër për periudhën tetor 1998 - mars 2000. Shuma: 784.794 lek.
- **Të ardhura** vetëm nga paga si pedagoge në Shkollën e Magjistraturës, për periudhën nga viti 2000 deri në datën e deklaramit. Shuma: 35.334.476 lek.
- **Të ardhura** të tjera nga punësime, si mësimdhënie jashtë Shkolla e Magjistraturës, Fakulteti i Drejtësisë UT (2001- 2018), Fakultete private, doktoratura, projekte, konsulenca, organizata ndërkombëtare. Të gjitha shpërblime të depozituara në banka nga viti 2005 deri në maj 2018 (në LEK - duke zbritur pagën nga Shkolla e Magjistraturës). Shuma: 27.560.682 lek.
- **Të ardhura** të tjera, nga projekte, konsulenca, organizata ndërkombëtare, përfshi dieta dhe bursa. Të gjitha shpërblime të depozituara në banka nga viti 2005 deri në maj 2018 (në Euro). Shuma: 88.958 euro.
- **Të ardhura** nga shitja e banesës në hyrje të Vlorës, të fituar me trashëgimi nga prindërit dhe në bashkë pronësi me vëllain D.B. Në çastin e shitjes, depozituar në Pro Credit Bank. Shuma: 32.470 euro.
- **Të ardhura** të fituara me trashëgimi, nga prindërit. Shuma: 1.000.000 lek.
- **Të ardhura** të tjera, nga projekte, konsulenca, organizata ndërkombëtare, përfshi dieta dhe bursa. Të gjitha shpërblime të depozituara në banka nga viti 2005 deri në maj 2018 (në Usd). Shuma: 48.417 Usd.
- **Të ardhura** nga konsulenca, ekspertiza, trajnimet, avokatia, interesat bankare, etj., për periudhën maj 2018 - dhjetor 2018. Shuma: 3.658.800 lek.
- **Të ardhura** nga konsulenca, ekspertiza, trajnimet, avokatia, interesat bankare, etj., për periudhën 2019 - 2021. Shuma: 11.580.500 lek.
- **Të ardhura** nga konsulenca, ekspertiza, trajnimet në organizata ndërkombëtare, për vitin 2022. Shuma: 15.494 euro.
- **Të ardhura** nga ekspertiza, botime, trajnimet, interesat bankare, etj., për vitin 2022. Shuma: 860.000 lek.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Veprim në arkë** nga Raiffeisen Bank, datë 15.06.2006, për tërheqjen Cash nga llogaria e S.B, të shumës 1.591.597 lek, nga klientët A.M dhe D.B. Bashkëlidhur: Veprim në

Arkë nga Raiffeisen Bank, datë 15.06.2006, për depozitimin cash në Llogari të A.M. të shumës 795.728 lek; Veprim në Arkë nga Raiffeisen Bank, datë 15.06.2006, për depozitimin cash në Llogari të D.B, të shumës 795.728 lek.

- **Vendim nr. ** datë 16.09.2005** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësit S.B dhe S.B, me trashëgimtarë A.M dhe D.B.
- **Certifikatë për vërtetim pronësie** lëshuar në datën 25.11.2005 (e mbyllur), për pasurinë nr. ** vol. *, faqe **, Zk **, e llojit Apartamenti me sipërfaqe 64 1712, me adresë: P. **, Vlorë; regjistruar në bashkë pronësi të A.M dhe D.B.
- **Certifikatë për vërtetim pronësie** nr. **, lëshuar në datë 26.02.2008 (e mbyllur), për pasurinë nr. **, vol. *, faqe **, Zk **, e llojit Njësi me sipërfaqe 64 m², me adresë: Rruga **, Lagjja ** P. **, Shkalla **, AP. ** Vlorë, regjistruar në bashkë pronësi të A.M. dhe D.B. Bashkëlidhur: Praktika e ndryshimit të destinacioni; nga ambiente banimi në dyqane në katin e parë të pallatit nr. **, Lagjja **.
- **Kontratë shitje** nr. ** rep., nr. ** kol., datë 5.03.2008, me shitës A.M (e përfaqësuar me prokurë nga E.V) dhe D.B, blerës H.S, për shitjen e pasurisë nr. **, vol. ** faqe **, Zk **, e llojit njësi, me sipërfaqe 64 m², me adresë: Rruga **, Lagjja ** P. **, Shkalla ** Kati. **, AP. **, Vlorë. Vlera 4.294.400 lek, e likuiduar dhe nga e cila pjesa takuese sipas bashkëpronësisë do të derdhet në Pro Credit Bank.
- **Statement nga Raiffeisen Bank**, printuar në datën 19.04.2023, për llogarinë në emër të A.M., ku rezulton kreditimi i të ardhurave në shumën totale rreth 2.655.000 lek, për periudhën 1.01.2022 - 31.12.2022.
- **Statement nga Raiffeisen Bank** printuar, në datën 19.04.2023, për llogarinë në emër të A.M, ku rezulton kreditimi i të ardhurave nga honorarët dhe pagesat, në shumën totale rreth 4.135 euro, për periudhën 1.01.2022 - 31.12.2022.
- **Statement nga Intesa Sanpaolo Bank**, printuar në datën 20.04.2023, për llogarinë në emër të A.M, ku rezulton kreditimi i të ardhurave, si ekspert, në shumën totale rreth 728.500 lek, për periudhën 1.01.2022 - 31.12.2022.
- **Statement nga Intesa Sanpaolo Bank**, printuar në datën 20.04.2023, për llogarinë në emër të A.M, ku rezulton kreditimi i të ardhurave nga International Labour Office dhe nga Këshilli i Europës, në shumën totale rreth 11.360 euro, për vitin 2022. Statement nga Intesa Sanpaolo Bank, printuar në datën 28.07.2022, për llogarinë në emër të A.M ku rezulton kreditimi i të ardhurave në shumën totale rreth 1.025 GBP, për periudhën 1.12.2014 - 29.05.2017.
- **Statement nga Intesa Sanpaolo Bank**, printuar në datën 28.07.2022, për llogarinë në emër të A.M ku rezulton kreditimi i të ardhurave, në shumën totale rreth 36.000 USD për periudhën 26.04.2010 -31.12.2021.
- **Statement nga Intesa Sanpaolo Bank**, printuar në datën 28.07.2022, për llogarinë në emër të A.M në Lek, ku rezulton kreditimi i të ardhurave si ekspert, për periudhën 4.12.2009 - 3.6.2022.
- **Statement nga Intesa Sanpaolo Bank**, printuar në datën 28.07.2022, për llogarinë në emër të A.M, ku rezulton kreditimi i të ardhurave, në shumën totale rreth 67.037 euro për periudhën 4.05.2010 - 12.07.2022.

- **Statement nga Raiffeisen Bank**, printuar në datën 28.07.2022, për llogarinë në emër të A.M në Lek, ku rezulton kreditimi i të ardhurave, për periudhën 04.04.2005- 27.06.2022.
- **Statement nga Raiffeisen Bank**, printuar në datën 28.07.2022, për llogarinë në emër të A.M ku rezulton kreditimi i të ardhurave, në shumën totale rreth 47.150 euro, për periudhën 23.05.2016 - 31.05.2022.
- **Vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës** nr. ** prot., datë 27.04.2023, ku vërtetohet se ** ka përfituar të ardhura neto në shumën totale 35.334.476 lek, për periudhën 2000 - 2022, nga të cilat shuma totale rreth 4.505.000 lek, për periudhën 2000- 2005.

103. Hetimi i trupës së vlerësimit

Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 10.08.2023 konfirmon se në llogari të A.M rezulton kreditimi i të ardhurave nga pagat, dietat, shpërblimet dhe honorarët, në shumën totale rreth 1.125.000 lek, për periudhën 4.04.2005 - 31.12.2005 dhe në shumën totale rreth 38.795.000 lek, për periudhën 01.01.2006 - 04.04.2023.

- **Konfirmon** kreditimin e të ardhurave në shumën totale rreth 50.450 euro, për periudhën 23.05.2016- 19.12.2022, si dhe kreditimin me transfertë të shumës 6.994 euro nga Llogaria si Person Fizik, në datën 7.03.2023.
- **Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr. ** prot., datë 23.08.2023**, konfirmon se në emër të A.M rezulton llogari rrjedhëse me balancë 0 lek, në datën 27.04.2023. Referuar në statement bankar rezulton kreditimi i të ardhurave nga Fondacioni SEMA, në shumën totale rreth 180.000 lek, për periudhën 17.04.2014 - 16.06.2014.
- **Intesa Sanpaolo Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 21.09.2023**, konfirmon se në llogari të A.M rezulton kreditimi i Llogarisë në shumën totale rreth 30.388.700 lek, për periudhën 14.12.2006 - 31.03.2023, nga të cilat: shuma totale rreth 23.221.700 lek, si kreditime me përshkrimin “internal transfer”; si dhe shuma totale rreth 7.167.000 lek, për periudhën 4.12.2009 - 31.03.2023, si kreditim i të ardhurave nga pagat dhe interesat.
 - **Konfirmon** se në llogari të A.M, rezulton kreditimi i të ardhurave në shumën totale rreth 77.911 euro, për periudhën 4.05.2010 - 28.02.2023.
 - **Konfirmon** se në llogari të A.M rezulton kreditimi i të ardhurave në shumën totale rreth 36.035 USD, për periudhën 26.04.2010 - 31.03.2023.
 - **Konfirmon** se në Llogari të A.M rezulton kreditimi i të ardhurave në shumën totale rreth 1.025 GBP, për periudhën 1.12.2014 - 29.05.2017.
- **Tirana Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 14.08.2023** konfirmon se në llogari të A.M rezulton: kreditimi i të ardhurave nga Justicia në shumën totale 1.100.000 lek, periudhën 4.09.2008 - 26.07.2012.
 - **Konfirmon** se në Llogari të A.M, rezulton: hapja e depozitës me vlerë 3.500.000 lek në datën 16.06.2009, e mbyllur në datën 18.07.2017, si dhe kreditimi i interesave në shumën totale rreth 814.000 lek, për periudhën 16.09.2009 - 20.06.2017; hapja e depozitës me vlerë 3.080.888 lek, në datën 20.07.2017, e mbyllur në datën 22.07.2022, si dhe kreditimi i interesave në shumën totale rreth 58.000 lek, për periudhën 20.07.2018-22.07.2021; hapja e depozitës me vlerë 2.500.000 lek, në datën 07.05.2018, e mbyllur në datën 26.08.2022, si dhe kreditimi i interesave në shumën totale rreth 17.000 lek, për periudhën 26.08.2020 - 26.08.2021.

- **Konfirmon** se në llogari të A.M rezulton: hapja e depozitës me vlerë 49.150 euro, në datën 16.06.2009, e mbyllur në datën 7.08.2013, si dhe kreditimi i interesave në shumën totale rreth 5.742 euro, për periudhën 9.08.2010-7.08.2012; hapja e depozitës me vlerë 15.000 euro, në datë 17.05.2013, e mbyllur në datën 13.08.2014, si dhe kreditimi i interesave në shumën totale 351 euro, në datën 3.07.2014; hapja e depozitës me vlerë 56.523 euro, në datën 7.08.2013, e mbyllur në datën 7.10.2016, si dhe kreditimi i interesave në shumën totale rreth 1.356 euro, për periudhën 7.08.2014 - 8.08.2016.
- **Pro Credit Bank, me shkresën nr. **prot., datë 14.08.2023**, konfirmon se në emër të AM rezultojnë: llogari depozitë në Euro, e hapur në datë 11.03.2008 dhe e mbyllur në datë 10.10.2008, si dhe llogari rrjedhëse në Euro e hapur në datë 31.03.2004 dhe e mbyllur në datë 10.04.2011. Referuar në statement bankar rezulton: kreditimi i të ardhurave dhe dietave në shumën totale rreth 15.750 euro, për periudhën 29.04.2004 - 12.05.2008; si dhe kreditimi i shumës 31.200 euro, në datë 05.03.2008, me përshkrim “nga Hajri Sulejmani..”.
- **Konfirmon** se në emër të A.M rezulton llogari rrjedhëse në Lek, e hapur në datën 14.11.2006 dhe e mbyllur në datën 10.04.2011. Kreditimi i të ardhurave nga Justicia shpk., në shumën totale rreth 540.000 lek, për periudhën 10.03.2008 - 16.05.2008.
- **Konfirmon** se në emër të A.M rezultojnë: llogari kursimi në USD e hapur dhe e mbyllur në datën 12.12.2000 llogari rrjedhëse në USD, e hapur në datën 4.03.2008 dhe e mbyllur në datën 14.07.2008. Referuar në statement bankar rezulton: kreditimi i të ardhurave si eksperte, në shumën totale rreth 385 USD, për periudhën 7.03.2008 - 19.05.2008.
- **Konfirmon** se në emër të A.M rezulton llogari depozitë në Lek, e mbyllur në datën 21.10.2008. Referuar në statement bankar rezulton: kreditimi cash i shumës 1.000.000 lek, në datën 18.09.2003, hapja e depozitës dhe kreditimi i interesave bankare në shumën totale rreth 365.000 lek, për periudhën 18.09.2004 - 21.10.2008.
- **Konfirmon** se në emër të A.M, rezulton llogari depozitë në Lek, e mbyllur në datën 4.10.2008. Referuar në statement bankar rezulton: kreditimi cash i shumës 1.250.000 lek, në datën 3.10.2003, hapja e depozitës dhe kreditimi i interesave bankare në shumën totale rreth 440.000 lek, për periudhën 3.10.2004- 4.10.2008.
- **Konfirmon** se në emër të A.M rezultojnë: llogari kursimi në Lek e hapur në datën 18.09.2003 dhe mbyllur në datën 19.05.2021, si dhe llogari depozitë në Lek, e mbyllur në datën 30.09.2008. Referuar në statement bankar rezulton: kreditimi cash i shumës 1.400.000 lek, në datën 30.09.2004, hapja e depozitës dhe kreditimi i interesave bankare në shumën totale rreth 350.000 lek, për periudhën 30.09.2005 - 30.09.2008.
- **Konfirmon** se në emër të A.M rezultojnë: llogari kursimi në EUR e hapur në datën 12.12.2000 dhe e mbyllur në datën 6.02.2002, llogari kursimi në EUR e hapur në datën 12.12.2000 dhe e mbyllur në datën 19.05.2021, si dhe llogari depozitë në Euro, e mbyllur në datën 10.10.2008. Referuar në statement bankar rezulton: kreditimi cash i shumës totale rreth 820 euro deri në datën 6.02.2002, hapja e depozitës me vlerë 822

euro, në datë 11.08.2005 dhe kreditimi i interesave bankare në shumën totale rreth 80 euro, për periudhën 11.08.2006 - 11.08.2008.

- **Credins Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 2.10.2023** konfirmon se në Llogari të A.M rezulton kreditimi i të ardhurave nga paga, honorarët dhe dietat në shumën totale rreth 32.742 euro, për periudhën 11.11.2011 - 28.03.2018.
 - **Konfirmon** se në emër të A.M, rezulton llogari rrjedhëse në Lek, e mbyllur në datë 30.08.2017. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi i të ardhurave nga paga, honorarët dhe dietat, në shumën totale rreth 285.000 lek, për periudhën 6.12.2013 - 21.03.2014.
- **Union Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 7.09.2023** konfirmon se në emër të A.M rezulton llogari rrjedhëse në Lek, e mbyllur në datën 05.03.2012. Referuar në statement bankar rezulton kreditimi i të ardhurave nga pagat, në shumën totale rreth 605.000 lek, për periudhën 02.11.2010 - 31.01.2012.
- **OKB, me shkresën nr. ** prot., datë 14.08.2023** konfirmon se AM e ditëlindjes 18.10.1963, figuron si Person Fizik me NUIS (NIPT) **, regjistruar në datën 24.11.2021, me fushë veprimtarie “eksperte në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare për studime, trajnime, etj. vend ushtrimi të aktivitetit “** Rr.**”, nr. ** “, dhe çregjistruar në datën 25.11.2022 (sipas çështjes *****).
- **D.P.Tatimeve, me shkresën nr. ** prot., datë 21.08.2023** konfirmon se AM, figuron si Person Fizik me NIPT **, regjistruar pranë D. R. T Tiranë në datën 24.11.2021.
- **DR. Tatimore Tiranë, me shkresën nr. ** prot., datë 25.08.2023**, konfirmon se AM e ditëlindjes 18.10.1963, figuron e regjistruar në datën 24.11.2021, si Person Fizik me NIPT **, me Objekt “aktivitete juridike”, me status 'kërkesë për çregjistrim ' prej datës 13.10.2022. Referuar sistemit tatimor C@ts, për periudhën 2021 - 2022, subjekti tregtar ka realizuar qarkullim me vlerë totale rreth 3.307.834 lek, nga e cila fitim pas tatimit, në shumën totale rreth 3.280.362 lek. Gjithashtu, konfirmon se A.M e ditëlindjes 18.10.1963, rezulton e regjistruar si individ privat me përgjegjësinë tatimore DIVA (deklarim individual vjetor i të ardhurave), për periudhën 2011 2022.
 - **DIVA II-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 1.445.802 lek, të ardhura bruto të tjera 3.240.195 lek; në total në shumën 4.685.997 lek, nga të cilat tatimi i Llogaritur në shumën 469.676 lek.
 - **DIVA 12-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 3.224.327 lek, të ardhura bruto të tjera 1. 798.578 lek; në total në shumën 5.022.905 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 625.340 lek.
 - **DIVA 13-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 3.106.962 lek, të ardhura bruto të tjera 2.165.805 lek; në total në shumën 5.272. 767lekë, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 507.392 lek.
 - **DIVA 14-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 1.572.840 lek, të ardhura bruto të tjera 5.483.655 lek; në total në shumën 7.056.495 lek, nga të cilat tatimi i Llogaritur në shumën 843.509 lek.
 - **DIVA 15-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 1.593.808 lek, të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të R. SII. 559.193 lek, të ardhura bruto të tjera

- 7.602.045 lek; në total në shumën 9.755.046 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 1.224.186 lek.
- **DIVA 16-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 1.690.621 lek, të ardhura bruto të tjera 6.107.679 lek; në total në shumën 7.798.300 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 1.101.741 lek.
 - **DIVA 17-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 11.813.708 lek, të ardhura bruto të tjera 7.060.980 lek; në total në shumën 8.874.688 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 1.276.377 lek.
 - **DIVA 18-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 1.765.750 lek, të ardhura bruto nga interesat bankare 26.906 lek, të ardhura bruto të tjera 5.152.737 lek; në total në shumën 6.945.393 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 983.265 lek.
 - **DIVA 19-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 3.573.248 lek, të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të R.SII. 36.600 lek, të ardhura bruto të tjera 3.197.165 lek; në total në shumën 6.807.013 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 1.080.156 lek.
 - **DIVA 20-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 3.698.672 lek, të ardhura bruto të tjera 4.297.833 lek; në total në shumën 7.996.505 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 1.268.573 lek.
 - **DIVA 21-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 3.602.875 lek, të ardhura bruto nga interesat 1.878 lek, të ardhura bruto të tjera 6.013.920 lek; në total në shumën 9.618.673 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 1.504.232 lek.
 - **DIVA 22-A** ku rezulton: të ardhura bruto nga punësimi 3.771.498 lek, të ardhura bruto nga interesat 38.461 lek, të ardhura bruto të tjera 2.659.834 lek; në total në shumën 6.469.793 lek, nga të cilat tatimi i llogaritur në shumën 1.000.387 lek.
 - **ISSH me shkresën nr. ** prot., datë 14.08.2023**, konfirmon se për A.M janë paguar kontributet shoqërore dhe shëndetësore për pagën bruto dhe ka përfituar të ardhura nga paga neto: nga subjekti Shkolla e Lartë Universitare Jopublike/Universiteti Luarasi) në periudhën janar 2012 - nëntor 2015; nga subjekti “Shkolla e Magjistraturës” për periudhën janar 2012 - dhjetor 2022; nga subjekti “U.E.T / European Education Initiative” për periudhën prill 2013 - qershor 2015; nga subjekti “Fakulteti i Drejtësisë” në periudhën nëntor 2015 - qershor 2023; nga subjekti A.M ' në periudhën nëntor 2021 tetor 2022; nga subjekti “Këshilli i Lartë i Prokurorisë” në periudhën tetor 2022 - korrik 2023.
 - **ISSH me shkresën nr. ** prot., datë 14.08.2023**, i kërkon informacion Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, për të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur, për periudhën para vitit 2012.
 - **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. ** prot., datë 24.08.2023**, sqaron se për periudhën 1994 - 2012, nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave të punonjësve të siguruar në subjekte shtetërore, juridik, fizik, nuk mund të konfirmohet periudha e kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, n.q.s. Nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës për shtetasit për të cilët kërkohen të dhëna.

104. Në proces-verbalin e datës 30.04.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka paraqitur relacion me shkrim dhe dokumentacion shtesë, duke konfirmuar të ardhurat sipas dokumentacionit të paraqitur dhe transaksioneve bankare, të cilat kanë shërbyer si burim financiar për krijimin e aseteve dhe përballimin e shpenzimeve familjare për jetesë. Subjekti sqaroi se aktualisht është objektivisht e pamundur të specifikohet burimi i të ardhurave për secilin kreditim bankar duke konfirmuar se për të gjitha të ardhurat e kredituar dhe të deklaruar, janë paguar detyrimet sipas përcaktimeve kontraktuale dhe ligjore, për të cilat nuk disponohet dokumentacion shtesë, duke konfirmuar të ardhurat e bashkëshortes si Person Fizik, të cilat janë evidentuar si pjesë e të ardhurave nga aktivitetet e ndryshme si eksperte, konsulente.

Me inventarin nr. ** prot., datë 30.04.2024, subjekti ka dorëzuar:

- **Relacion** nga I.M, ku ka sqaruar se të ardhurat e bashkëshortes A.M ndër vite, nga koha kur ka filluar të funksionojë sistemi bankar në Republikën e Shqipërisë, kanë kaluar të gjitha nëpërmjet sistemit bankar, duke saktësuar se deklarimi i të ardhurave është bërë duke pasur në konsideratë institucionin nga kanë buruar të ardhurat dhe jo Llogari të bankare, ku ato mund të kenë kaluar.
- **Lidhur** me të ardhurat nga shitja e banesës në vlerën 32.470 euro, subjekti ka sqaruar se të ardhurat nga shitja e këtij objekti i janë kaluar me bankë bashkëshortes, vetëm për shumën që i përket asaj, për shkak të marrëdhënies trashëgimore dhe ndarjes së pasurive midis motrës dhe vëllait.
- **Lidhur** me të ardhurat e fituara me trashëgimi, deklaruar në shumën 1.000.000 lek, subjekti sqaroi se kjo shumë përbëhet nga tërheqja e gjendjes së Llogarisë në Raiffeisen Bank, në shumën gjithsej prej 1.591.597 lek, nga të cilat: 50% i ka kaluar bashkëshortes, si trashëgimtare, në shumën prej 795.728 lek dhe diferenca prej 204.272 lek është përfituar nga gjendja cash e nënës së bashkëshortes në shtëpi.

105. Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit z. I.M , nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruar nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

- ✓ Deklarimet e subjektit Ilirjan Mandro rakordohen deklarimet me shkresat e ardhura nga institucionet përkatëse.
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve konfirmon pagesën e detyrimeve tatimore për të gjitha të ardhurat nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

C. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germa (ë), e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

✚ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit **z. Ilirjan Mandro** me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, për vlerësimin e kontrollit të figurës ka dorëzuar nëpërmjet shkresës Nr.*** datë 22.12.2023 raportin e kontrollit të figurës² ku ka konstatuar se:

- ✓ **Subjekti i vlerësimit z. Ilirjan Mandro, me detyrë Rektor i “Akademisë së Sigurisë”, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Ka mbiemër tjetër nga ai që ka patur apo ka regjistruar në gjendjen civile.

² Raport për kontrollin e figurës

- Nuk ka pasur apo ka shtetësi tjetër.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk ka është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë ndaj tij masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar
- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.

Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e vlerësimit konstatoi se:

Në mbështetje të neneve 35-42, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar trupa e vlerësimit zhvilloj hetimin mbi kontrollin e figurës duke u bazuar në kthim përgjigjet e institucioneve ligj zbatuese në Republikën e Shqipërisë, raportin e Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit dhe deklaratimet e subjektit të vlerësimit **nga ku u konstatua:**

106. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën “I kufizuar”, nr. **** prot., datë 18.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro bën me dije se:

- a. **Me datë 30.03.1985, ka ndryshuar Rubrikën e mbiemrit nga “Serjanaj” në “Mandro”,** sipas të dhënave të pasqyruara në regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë të vitit 1974, lagjja **, me referencë ***.
- b. Nuk ka ndryshuar shtetësi (lenie ose marrje shtetësie)

Në “Në deklaratën e Kontrollit të Figurës” subjekti ka deklaruar se “...me dëshirën time dhe miratimin e prindërve, të cilët janë divorcuar kur isha i mitur, në moshë madhore, vendosa të marr mbiemrin e nënës, Mandro...”.

107. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën “I kufizuar”, nr. **** prot., datë 10.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro bën me dije se:

- a. Nuk rezultoi i dënuar

108. Institucion Ligjzbatues me shkresën “Sekret”, nr. **** prot., datë 17.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro bën me dije se:

- a. Nuk disponon të dhëna.

109. Institucion Ligjzbatues me shkresën “I kufizuar”, nr. **** prot., datë 18.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro si dhe për personat e lidhur sipas certifikatës familjare nuk kanë:

- a. Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimin e ngritur në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
- b. Të dhëna për kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.95/2016, “për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”) ku mund të përfshihen biseda, foto, vëzhgime takimesh apo biseda telefonike etj.;
- c. Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (të dënuar ose proceduar penalisht, brenda apo jashtë territorit të republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, “për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë i ndryshuar.);

- d. Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- e. Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e ndonjë vepre penale.
- f. Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhër-arresti ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
- g. Të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
- h. Të dhëna për gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO.
- i. Të dhëna që nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- j. Nuk ka procedime disiplinore apo masa disiplinore

110. Institucion Ligjzbatues, me shkresën “Konfidencial”, nr. **** prot., datë 16.08.2023., për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro bën me dije se:

- a. Nuk disponon të dhëna.

111. Institucion Ligjzbatues, me shkresë “sekret”, e datës 03.08.2023, shkresën “sekret”, nr. **** prot., datë 19.06.2023, dhe shkresën “sekret”, nr. ****. prot, datë 03.10.2023, për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare bën me dije se:

- a. Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të paligjshëm;

112. Institucion Ligjzbatues, me shkresën “i kufizuar”, nr. ****. prot, datë 31.10.2023 për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro bën me dije se:

- a. Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
- b. Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
- c. Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo presonit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
- d. Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprës penale;
- e. Nuk ka pasur raste të urdhrit ndërkombëtar të ndalimit;

113. Institucion Ligjzbatues, me shkresën “i kufizuar”, nr. **** prot., 16.08.2023, bën me dije se, për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro :

- a. Nuk rezulton të jetë regjistruar procedimi penal.
- b. Nuk është marre në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;

114. Institucion Ligjzbatues, me shkresën “sekret”, nr. **** prot., datë 18.08.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Ilirjan Mandro dhe personat e lidhur me të:

- a. Rezultuan raportime për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Kadri Mandro dhe personin e lidhur me të Arta Mandro, sipas aneks I.

b. Disponohen të dhëna për shtetasin I.M dhe A.M si vijon:

Më datë 30.01.2016 në prani të noterit E. L., shtetasi I.M dhe A.M, në cilësinë e blerësve, kanë lidhur kontratë me nr. *** Rep., Nr. *** Kol. me palë paditëse shoqërinë “****” shpk

dhe “***” shpk, me objekt blerjen e pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament” me sipërfaqe 71 m², të ndodhur në Vlorë dhe me çmim shitje 45.840 Euro.

c. Nuk rezultojnë raportime për personin e lidhur A.M.

115. Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar, me shkresën ‘i kufizuar’, nr. *** prot., datë 15.08.2023 për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro bën me dije se:

- a. Nuk është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), të vlefshme.
- b. Për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
- c. Nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

116. Avokati i Popullit me shkresën “e paklasifikuar”, me nr. **** prot., datë 21.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro bën me dije se:

- a. Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- b. Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

117. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën “I kufizuar”, nr. *** prot., datë 24.11.2023, për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro, bën me dije se:

- a. Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 Korrik 1991.

118. Denoncime nga publiku

Për subjektin e vlerësimit z. Ilirjan Mandro nuk është disponuar asnjë ankesë nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

119. Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, me nr. ***, datë 20.11.2024, “Akt Ekzaminimi Toksikologjiko-Ligjor” konkludohet se subjekti vlerësimit z. **Ilirjan Mandro** :

✓ **Nuk janë zbuluar prania e substancave narkotike.**

120. Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Ilirjan Mandro, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për

kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit z. Ilirjan Mandro:

- *Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*
- *Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONAL

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

- Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:
 - të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
 - raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit/Gardën e Republikës/Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

Subjekti i vlerësimit **z. Ilirjan Mandro** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin **Rektor i “Akademisë së Sigurisë”**. Në momentin e hedhjes së shortit dhe përzgjedhjes së trupës së vlerësimit datë 05.04.2023 subjekti i vlerësimit mbante po funksionin e Rektor i “Akademisë së Sigurisë”.

- Periodha e vlerësimit në zbatim të nenit 44 pika 2 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar është periudha 5-vjeçare (2018-2022). Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale do të shkrihet brenda këtij harku kohor.

C/1 RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL POLICIA E SHETIT.

Struktura e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr.12/2018 i ndryshuar ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr. *** datë 01.09.2023 raportin e vlerësimit profesional është shprehur me konkluzion përfundimtar si më poshtë vijon:

- ✚ **Punonjësi i Policisë z. Ilirjan Mandro është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar funksionin që mban.**

C/2 HETIMI I TRUPËS SË VLERËSIMIT PRANË AGJENCISË SE MBIKËQYRJES POLICORE:

- ✚ Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me ligjin e vlerësimit si dhe ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, ka zhvilluar një hetim administrativ të plotë dhe të bazuar në fakte dhe prova duke u bazuar në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit nr. *** ;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS me nr. ***;
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.
- Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.

- ✚ Z. Ilirjan Mandro është dekretuar nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 276 “Për Emërimin e Rektorit të Akademisë së Sigurisë” si Rektor i Akademisë së Sigurisë.

- ✚ Punonjësi i Policisë, Drejtues i parë Ilirjan Mandro është emëruar në detyrë Rektor i “Akademisë së Sigurisë”. me urdhrin nr.*** datë 20.05.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

- ✚ Në zbatim të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Ilirjan Mandro bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

121. Vlerësimi i nivelit të arsimit.

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
Arsim i Lartë	Shkolla e Lartë MRP	1981	1984	Tiranë	Diplomë
Arsim i Lartë	Fakulteti i Shkencave Politike e Juridike (dega drejtësi)	1988	1981	Tiranë	Diplomë
Gradë Shkencore	Doktor në fushën e drejtësisë	1999			
Titull Shkencor	Profesor i asociuar “Mjeshtër Kërkimesh” në fushën juridike	1999			Dëshmi
Titull	Profesor në fushën e Drejtësisë	2004			Dëshmi

- Trupa e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore administroj nga dosja e subjektit të vlerësimit diplomat.
- Në kuptim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

Trupa e Vlerësimit konstaton se:

- ✓ Subjekti i vlerësimit gëzon nivelin e nevojshëm të arsimit për pozicionin e punës që mban.
- ✓ Në kuptim të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit.

✚ Hetimi i zhvilluar nga Trupa e Vlerësimit mbi trajnimet dhe kualifikimet e subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43-45, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

122. Certifikatat e trajnimeve, kualifikimet dhe medaljet:

✚ Trupa e vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstatoj se gjatë periudhës 5 vjeçare të vlerësimit në zbatim të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar subjekti i vlerësimit:

- I. **ka realizuar trajnime,**
- II. **ka marrë certifikatë për merita të veçanta dhe për shërbime të dalluara gjatë vitit 2016 dhe 2021.**

Trupa e vlerësimit vë në dukje faktin se, dokumentacioni bashkëlidhur raportit të vlerësimit, përmban certifikata trajnimesh për subjektin e vlerësimit të një periudhe relativisht të hershme për harkun kohor të viteve 2010-2023. Në përputhje me dispozitat e ligjit të vlerësimit kjo periudhë nuk është objekt vlerësimi dhe për këtë arsye këto kualifikime nuk do të trajtohen në kuadrin e kualifikimeve të përfituara nga subjekti i vlerësimit për periudhën (2018-2023)

Trupa e vlerësimit konstaton se:

- ✓ Gjatë periudhës së vlerësimit subjekti gëzon trajnime dhe certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave.

123. Vlerësimet e punës:

Gjatë zhvillimit të hetimit mbi procesin e vlerësimit të aftësive profesionale trupa e vlerësimit ka konstatuar se:

- Për periudhën e vlerësimit (2018-2022) në dosjen e subjekti të vlerësimit dhe në raportin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, subjekti ka 3 (tre) vlerësime pune, me vlerësim maksimal “**28 pikë**”, konkretisht për vitin 2018 - 2021 dhe nga viti 2022 e në vazhdim vlerësim maksimal me “**100 pikë**”.

Trupa e vlerësimit konstaton se:

- ✓ Subjektit ka vlerësime pune me vlerësim maksimal.

124. Masat disiplinore

Trupa e vlerësimit në zhvillim të hetimit ka kryer verifikime në dosjen personale të subjektit të vlerësimit si dhe në sistemin RMIS, nga ku rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare, (2018-2022) të përcaktuar në pikën 2 të nenit 44 të ligjit 2018 i ndryshuar, subjekti i vlerësimit nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.

Trupa e Vlerësimit konstaton se:

- ✓ Subjekti përgjatë periudhës së vlerësimit nuk ka asnjë masë disiplinore në ngarkim.

125. Ecuria në karrierë

Nga verifikimi i të dhënave të deklarimit të subjektit të vlerësimit, raportit të vlerësimit profesional nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, subjekti i vlerësimit Ilirjan Mandro ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej **40 vitesh e 4 muaj**. Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare objekt deklarimi, subjekti mban.

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. urdhri	Data	
			Nga	Deri
Drejtues i Parë	Dhënë grada me vendim gjyqësor	Nr.***, datë 16.09.2014	01.09.2014	22.05.2022
Drejtues i Lartë	Emëruar Drejtor/Rektor	Nr.***, datë 20.05.2022	23.05.2022	vazhdim

Data e fillimit	Data e përfundimit	Institucioni	Funksioni
26.10.2022	Vazhdim	Akademia e Sigurisë	Rektor
22.09.2016	25.10.2022	Akademia e Sigurisë	Drejtor/Dekan
15.06.2015	21.09.2016	Akademia e Sigurisë	Dekan/Drejtor i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit

Policia e Shtetit konkludon se:

- Nga të dhënat e faktit konstatohet se subjekti i vlerësimit gjatë periudhës së vlerësimit ka mbajtur funksionin “**Drejtor/Rektor**”, në përputhje me kriteret ligjore dhe gradën që disponon. Funksionet dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve në nënligjore.

Trupa e vlerësimit konstaton se:

- ✓ Nga të dhënat venë në dispozicion nga Policia e Shtetit, konstatohet se subjekti i vlerësimit gjatë periudhës së vlerësimit ka mbajtur funksionin “**Drejtor/Rektor**”, në përputhje gradën që disponon.
- ✓ Trupa e vlerësimit në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit z. Ilirjan Mandro, arrin në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe grada që ai ka përfituar, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

126. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshope, seminare botime brenda dhe jashtë vendit.

Trupa e vlerësimit konstaton se:

- ✓ Subjekti i vlerësimit gjatë periudhës 5-vjecare të vlerësimit, ka marrë pjesë në konferenca/ workshope/ seminare.

127. Në përfundim Trupa e Vlerësimit konstaton se subjekti i vlerësimit z. Ilirjan Mandro:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin:

Subjekti i vlerësimit z. Ilirjan Mandro:

- ✓ *Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;*
- ✓ *Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;*
- ✓ *Ka vlerësime pozitive pune.*

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupa Vlerësuese e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit z. Ilirjan Mandro në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale;

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi referuar nenit 59, germa “ç”, të si dhe nenit 62 germa “ç”, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

V E N D O S I

1. Konfirmimin në detyrë e subjektit të vlerësimit, **z. Ilirjan Mandro.**

2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë **06.12.2024**.

KRYESUES

EDONA DUSHAJ

RELATOR

ENTON RADOVANI

ANËTAR

HENRI NAQELLARI